

---

DOKUMENT POLITIKASH

ZMBRAPSJA E DEMOKRACISË  
DHE TKURRJA E HAPËSIRËS QYTETARE

—  
SI TA NDRYSHOJMË TRENDIN?

ILIADA KORÇARI

---

*Dhjetor 2020*

*Ky dokument u përgatit nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, me mbështetjen e Fondacionit Hanns Seidel Shqipëri. Çdo qëndrim apo opinion i shprehur në këtë projekt është i organizatës zbatuese dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit.*

## TABELA E PËRMBAJTJES

Abstrakti .....	3
Hyrje .....	4
Përkufizimi i problemit .....	6
Gjetjet.....	8
Lulëzim legjislacioni për forcimin e hapësirës qytetare përkundër zbatimit të dobët.....	8
Ngecja e progresit drejt mjedisit mundësues për shoqërinë civile.....	13
Spastrimi i medias dhe reforma e paketës anti-shpifje.....	19
Angazhimi i qytetarëve në vendimmarrje dhe demokracia pjesëmarrëse – praktika të konsultimit publik .....	23
Përgjigja civile ndaj politikave qeveritare.....	27
Ndikimi i kufizimeve të covid-19 mbi hapësirën qytetare.....	33
Përfundime dhe rekomandime .....	36
Referencat .....	41

## ABSTRAKTI

Dokumenti argumenton se tkurrja e hapësirës qytetare përbën një manifestim simptomatik të zbrapsjes demokratike në Shqipëri gjatë viteve 2015-2020, që ka kulmuar në 2018-2020. Ai ngrihet mbi supozimin se një hapësirë qytetare e fuqishme kontribuon në konsolidimin e demokracisë dhe nëse progresi në këtë drejtim pengohet, tkurrja e hapësirës qytetare bëhet një simptomë e bjerrjes demokratike. Studimi fokusohet në identifikimin e politikave dhe praktikave të veçanta të ekzekutivit që kanë ndikuar hapësirën qytetare në Shqipëri gjatë viteve 2015-2020, bazuar në analizën e tre aktorëve civilë: organizatat e shoqërisë civile, media dhe qytetaria. Ai tregon se mbiprodhimi i ligjeve që nuk janë të harmonizuara dhe të mbështetura nga aktet ligjore-administrative të nevojshme dhe nga burimet e mjaftueshme njerëzore dhe ekonomike, kanë sjellë zbatimin e dobët të legjislacionit që synon forcimin e hapësirës qytetare.

Spektori i shoqërisë civile ka pësuar nga qeveria trysni dhe kontroll të shtuar në aktivitetin e OShC-ve, që prej vitit 2019. Media ka dëshmuar një seri zbrapsjesh në lirinë e fjalës, veçanërisht që prej vitit 2018, ndërsa pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje dhe konsultime publike ka rënë në mënyrë drastike që prej viteve 2016-2017. Aktorë të ndryshëm në sektorin civil, media dhe komunitetet e qytetarëve kanë mbajtur një qëndrim aktiv kundër këtyre tendencave shqetësuese. Organizimi qytetar është përmirësuar dhe ka përfshirë përdorimin e mjeteve të reja si iniciativat ligjvënëse, paditë gjyqësore dhe ndërkombëtarizimi i kauzave qytetare. Pavarësisht kësaj, organizimet nuk kanë arritur të mobilizojnë masivisht qytetarë të paprekur në kauzat për të cilat ata kanë advokuar. Shumica e këtyre përpjekjeve qytetare nuk janë ndërlidhur me njëra-tjetrën dhe rrallë ia kanë dalë të ndikojnë politika qeveritare.

Fjalët kyçe: *tkurrja e hapësirës qytetare; organizatat e shoqërisë civile; media; qytetaria; demokratizimi.*

Raportet ndërkombëtare dhe organizatat vendore gjithnjë e më shumë po ngrenë alarmin për bjerrjen e demokracisë dhe nevojën për “me e përballë iliberalizmin” në vendet e Ballkanit Perëndimor.<sup>1</sup> Raporti i fundit i *Vendeve në Tranzicion 2020* nënvizoi se “drejtuesit politikë në rajon kanë rreshtur së u fshehuri pas fasadës së pajtueshmërisë nominale dhe janë duke sulmuar haptazi institucionet demokratike, në përpjekje për të hequr edhe ato pak mjete të mbetura që kontrollojnë pushtetin e tyre”.<sup>2</sup> Parashikimi i bërë nga raporti *Vendet në Tranzicion 2018*<sup>3</sup> u konfirmua në raportin e vitit 2020 të *Vendeve në Tranzicion*: regjimi hibrid ose demokracia tranzitore e Shqipërisë shënoi një zbrapsje të përgjithshme nga demokracia drejt autoritarizmit.<sup>4</sup> Por si reflektohet zbrapsja demokratike në hapësirën qytetare të Shqipërisë? Cilat politika apo praktika qeveritare specifike e kanë ndikuar këtë hapësirë gjatë viteve 2015-2020 dhe cilat kanë qenë pasojat e tyre deri më tani?

Ky dokument argumenton se gjatë viteve 2015-2020, tkurrja e hapësirës qytetare ka qenë një manifestim simptomatik i zbrapsjes demokratike në Shqipëri. Politikat dhe praktikat qeveritare nuk e kanë ndaluar rritjen natyrale të organizatave të shoqërisë civile (OShC)<sup>5</sup>, por kanë qenë gjithsesi një pengesë në mjedisin mundësues të zhvillimit të shoqërisë civile dhe në procesin demokratizues në përgjithësi, duke rezultuar në tkurrje të hapësirës qytetare. Tkurrja dhe zbrapsja demokratike janë veçanërisht të dukshme gjatë viteve 2018-2020. Në vend se të matet se sa është tkurrur hapësira qytetare në vend, dokumenti synon të vendosë nëse tkurrja është një trend në zhvillim e sipër dhe se cilat janë disa nga taktikat apo instrumentet më të dukshme që ka përdorur ekzekutivi për ta shkaktuar atë.

---

1 Schenkan, Nate (2018), ‘Vendet në tranzicion 2018 – Me përballë iliberalizmin’ (ang.), Freedom House, f. 3 ([https://freedomhouse.org/sites/default/files/2020-02/FH\\_NationsInTransit\\_Web\\_PDF\\_FINAL\\_2018\\_03\\_16.pdf](https://freedomhouse.org/sites/default/files/2020-02/FH_NationsInTransit_Web_PDF_FINAL_2018_03_16.pdf)).

2 Csaky, Zselyke (2020), ‘Vendet në tranzicion 2020 – Rënia e fasadës demokratike’ (ang.), Freedom House ([https://freedomhouse.org/sites/default/files/2020-04/05062020\\_FH\\_NIT2020\\_vfinal.pdf](https://freedomhouse.org/sites/default/files/2020-04/05062020_FH_NIT2020_vfinal.pdf)).

3 “Për Shqipërinë, 2018 përmban premtimin e një qeverisjeje të përmirësuar, po aq sa edhe rrezikun e autoritarizmit”. Shih më shumë në Kajsiu, Blendi (2018), ‘Vendet në tranzicion 2018 – Shqipëria’ (ang.), Freedom House (<https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2018>).

4 Sipas raportit *Vendet në tranzicion të 2018*, përqindja e demokracisë në Shqipëri ishte 48.21/100. Raporti *Vendet në tranzicion 2019* nuk shënoi ndryshime në pikëzim. Raporti *Vendet në tranzicion 2020* e vlerësoi demokracinë me përqindjen 47.02/100, me një rënie prej 1.19 pikësh. Shih <https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2018> dhe vitet përkatëse 2019, 2020.

5 Me marrëveshje fjalë, akronimi OShC përfshin të gjitha llojet e organizimeve brenda shoqërisë civile, të tilla si organizata të shoqërisë civile, organizata jo-qeveritare, organizata jofitimprurëse, nisma qytetare, etj., me përjashtim të rasteve kur qartësohet ndryshe.

Metodologjikisht, dokumenti përdor të dhëna parësore cilësore dhe sasiore. Rishikimi i literaturës, raportet dhe lajmet e nxjerra në media hedhin bazat për grumbullimin e të dhënave cilësore dytësore. Intervistat gjysmë të strukturuar me aktivistë të shoqërisë civile dhe të dhënat sasiore të mbledhura nga raportet e *Besimit në Qeverisje (2015-2020)*<sup>6</sup> janë përdorur për të vërtetuar gjetjet që dolën nga analiza e të dhënave dytësore. Dokumenti nuk prodhon të dhëna të reja, por lidh informacionin ekzistues nën një qasje krahasuese dhe nën një perspektivë më pak të eksploruar.

Pas hyrjes, dokumenti parashtron shkurtimisht problemin e tkurrjes së hapësirës qytetare. Jep një përkufizim të fenomenit dhe bën një rishikim të shpejtë të literaturës gri, që përmbledh raporte dhe analiza politikash. Pjesa e gjetjeve fokusohet në analizën e legjislacionit dhe politikave të ndërmarra nga qeveria në lidhje me zhvillimin e hapësirës qytetare dhe reagimit të aktorëve të përfshirë: OShC-të, media dhe qytetarët. Ajo fillon me një analizë të përgjithshme të legjislacionit të nxjerrë mbi ca elementë të hapësirës qytetare. Vazhdon me zbatimin e politikave për mjedisin mundësues të organizatave të shoqërisë civile; me praktikën dhe politikën qeveritare ndaj medias; me pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes përmes konsultimit publik dhe protestave; reagimin qytetar ndaj politikave qeveritare dhe së fundi me efektet e pandemisë COVID-19 në hapësirën qytetare të Shqipërisë. Dokumenti përmbyllet me përfundimet dhe rekomandimet se si mund të përmirësohet hapësira qytetare në Shqipëri.

---

<sup>6</sup> Sondazhi i opinionit publik Besimi në Qeverisje është një sondazh vjetor i zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) që prej vitit 2014 me mbështetjen e PNUD Shqipëri. Të gjitha raportet mund të shkarkohen nga <https://idmalbania.org/trust-in-governance/>.

## P Ë R K U F I Z I M I I P R O B L E M I T

Sipas CIVICUS-së, hapësira qytetare është hapësira ku “qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile mund të organizohen, të marrin pjesë dhe të komunikojnë pa pengesa [...] me pasë mundësi për të kërkuar të drejtat e tyre dhe të ndikojnë strukturat politike dhe sociale përreth tyre”<sup>7</sup>. Ndër të tjera, gjallëria e hapësirës qytetare matet me progresin e arritur në drejtim të konsolidimit të të drejtave të njeriut dhe ato civile, pjesëmarrjes së qytetarëve në hapësirën publike dhe qytetare, qëndrueshmërisë dhe ripërtëritjes së shoqërisë civile, funksionimit të sindikatave të punëtorëve, përfshirjes së komuniteteve në proceset e politikëbërjes dhe pavarësisë së medias. Për pasojë, tkurrja e hapësirës qytetare nënkupton pengimin, vonimin ose ndalimin e organizimit dhe pjesëmarrjes sociale të këtyre aktorëve në shoqëri. Hapësira qytetare pra lidhet me procesin e demokratizimit.

Fenomeni i tkurrjes së hapësirës qytetare në Shqipëri shfaqet në 2016 në literaturën gri.<sup>8</sup> Prej atëherë, termi ka marrë më shumë njohje dhe prani ligjërimore. Disa nga indikatorët e tkurrjes së hapësirës qytetare përfshijnë një diskreditim të dyfishtë të imazhit dhe punës së OShC-ve të angazhuara në advokaci dhe monitorim<sup>9</sup> nga zyrtarët e lartë të qeverisë në një të anë. Si dhe diskreditimin nga media të OShC-ve që japin shërbime, duke pretenduar se aktiviteti i tyre nuk ka ndikim shoqëror.<sup>10</sup> Bino et al mendojnë se kapja e OShC-ve nga partitë politike, ikja e trurit dhe mungesa e burimeve njerëzore të specializuara në sektorin e shoqërisë civile dhe më gjerë në shoqëri, janë tregues të tkurrjes.<sup>11</sup> Ndërsa Mirel dhe Vurmo argumentojnë se plotfuqia e qeverisë e ka kufizuar pjesëmarrjen e aktorëve civilë në vendimmarrje.<sup>12</sup>

---

7 CIVICUS Monitor, ‘Hapësira qytetare’ (ang.) (<https://monitor.civicus.org/whaticivicspace/>).

8 Vurmo, Gjergji (2020), ‘Ligjet me porosi në Ballkanin Perëndimor: Kapje e maskuar e shtetit’ (ang.), Bruksel: CEPS 11 maj (<https://www.ceps.eu/ceps-publications/tailor-made-laws-in-the-western-balkans/>).

9 Azizaj, Evelina dhe Romario Shehu (2020) Indeksi i qëndrueshmërisë së organizatave të shoqërisë civile për Shqipërinë 2019 (ang.), USAID, ICNL, fhi360, IDM, f. 9 (<https://idmalbania.org/csosi-usaid-report-for-albania/>).

10 USAID, ICNL, fhi360 (2019), Indeksi i qëndrueshmërisë së OShC-ve në 2018 për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Euroazinë (ang.), shtator, f. 19 (<https://idmalbania.org/csosi-usaid-report-for-albania/>). Bino, Blerjana et al (2020), Pjesëmarrja e shoqërisë civile në vendimmarrje në Shqipëri (ang.) Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, f. 18 (<https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2020/03/CSO-Participation-in-Decision-Making-in-Albania.pdf>).

11 Bino, Blerjana et al (2020), Pjesëmarrja e shoqërisë civile në vendimmarrje në Shqipëri, f. 18.

12 Mirel, Pierre (2019), ‘Bashkimi Evropian-Ballkani Perëndimor: për një kuadër të riparë negociatash anëtarësimi’ (ang.), Fondation Robert Schuman (<https://www.robert-schuman.eu/en/european-issues/0529-european-union-western-balkans-for-a-revised-membership-negotiation-framework>). Vurmo, Gjergji (2020), ‘Vendet në tranzicion

Raportet ndërkombëtare tregojnë se demokracia e Shqipërisë është zbrapsur drejt autoritarizmit dhe në vend është duke u konsoliduar një regjim hibrid. Sipas raportit *Vende në Tranzicion*<sup>13</sup>, midis viteve 2015-2018 qeverisja demokratike ka pasur vlerësim të qëndrueshëm prej 3.50/7.00 pikë, i cili ra në 3.25 në 2019. Vlerësimi i medias së pavarur shkoi nga 4.00/7.00 në 2015, në 3.75 mes viteve 2016 dhe 2019. Ama, rezultatet e shoqërisë civile kanë mbetur të pandryshuara në 5.00/7.00 pikë në të njëjtën periudhë. Të dhënat duket se sugjerojnë se sektori nuk është drejtpërdrejt i ndikuar nga ndryshimet në nivelin e demokratizimit, teksa hapësira qytetare është e ndikuar në tërësinë e saj. Kjo i shërben OShC-ve si një kujtesë për të mos e përvetësuar hapësirën qytetare si hapësirën e tyre ekskluzive.<sup>14</sup>

Problemi i tkurrjes së hapësirës qytetare në Shqipëri u bë i pamohueshëm gjatë urgjencës së tërmetit në 2019 dhe pandemisë COVID-19 në 2020. Me deklarimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, qeveria ndërmori kufizime të drejtave civile.<sup>15</sup> Shpërthimi i COVID-19 në mars 2020 shpalosi më tutje problemin i cili u bë i dukshëm edhe mes demokracive të konsoliduara: një shoqëri civile e dobët nuk mundet veçse ta dëshmojë “zbrapsjen demokratike [...] e cila eventualisht merr tatëpjetën në një spirale drejt autoritarizmit.”<sup>16</sup>

---

2020 – Shqipëria’, Washington DC: Freedom House (<https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2020>).

13 Rezultati i raporteve Vendet në Tranzicion të Freedom House-it bazohet në një shkallë nga 1 në 7, ku 1 nënkupton nivelin më të ulët dhe 7 nivelin më të lartë të demokracisë. Rezultati i demokracisë përbën një mesatare të shtatë indikatorëve dhe shprehet gjithashtu në përqindje, ku 0 nënkupton nivelin më të ulët dhe 100 nivelin më të lartë të demokracisë. Shih <https://freedomhouse.org/reports/nations-transit/nations-transit-methodology>.

14 Balkan Civil Society Development Network (2018), ‘Çfarë duhet të bëjmë për të promovuar hapësirën qytetare?’ (ang.), f. 7 (<http://www.balkancsd.net/novo/wp-content/uploads/2018/04/Pogledite-na-zapaden-balkan-i-turcija-ANG-01.pdf>),

15 Dyrmishi, Arjan nw Brandle et al (2020), Demokracia dhe gjendja e emergjencës (ang.), Friedrich Erbert Stiftung 13 korrik f. 4-7 (<http://library.fes.de/pdf-files/bueros/belgrad/16359.pdf>); Shehu, Isuf et al (2020), Sundimi i ligjit në urgjencë: një analizë e rastit shqiptar, Tiranë: Akademia e Studimeve Politike, maj.

16 Pornschlegel, Sophie (2020), ‘Me ju kundërvënë hapësirave në tkurrje: rekomandime për të mbështetur shoqërinë civile të BE-së’ (ang.), European Policy Centre, 11 qershor, f. 12 ([https://wms.flexious.be/editor/plugins/imagemanager/content/2140/PDF/2020/Countering\\_shrinking\\_spaces.pdf](https://wms.flexious.be/editor/plugins/imagemanager/content/2140/PDF/2020/Countering_shrinking_spaces.pdf)).



## Lulëzim legjislativ për forcimin e hapësirës qytetare përkundër zbatimit të dobët

Shumica qeverisëse ka qenë mjaft efektive në hartimin e legjislativ gjatë viteve 2015-2020. Sipas Vurmos, 80% - 85% e legjislativ të miratuar në kuvend është filluar nga ekzekutivi. Mesatarisht, Kuvendi i Shqipërisë ka nxjerrë 268 akte ligjore në vit. Që do të thotë se koha mesatare që kanë harxhuar ligjvënësit për një akt ligjor ka qenë veç një gjysmë dite pune.<sup>17</sup> Ky proces legjislativ kaq i dendur e në kohë të shkurtër ka sjellë dy pasoja kryesore: një nevojë të shtuar për amendime ligjesh dhe shtyrjen e zbatimit të tyre. Të dyja kanë pasur ndikim negativ në hapësirën qytetare. Duke qenë të vetëdijshëm për sfidën për të “vlerësuar nivelin e zbatimit të legjislativ për të drejtat e njeriut, të politikave, analizave dhe strategjive [...] për shkak të mungesës së monitorimeve gjithëpërfshirëse dhe të dhënave”<sup>18</sup>, kjo pjesë bën një përpjekje për të analizuar efektet e legjislativ në hapësirën qytetare gjatë viteve 2015-2020.

Raporti i Komisionit Evropian (KE) *Shqipëria 2020* vëren se fundi i vitit 2019 dhe 2020 shënjuan pikën kulmore të numrit të akteve normative të nxjerra nga qeveria. Periudha përkon me gjendjen e fatkeqësive natyrore të shpallur pas tërmetit të nëntorit 2019, që u pasua nga shpërthimi i COVID-19 që prej marsit 2020.<sup>19</sup> Gjatë nxjerrjes së shpejtë të legjislativ, kuvendi ka kaluar shumë ligje të cilat kontribuojnë në rregullimin dhe zhvillimin e hapësirës qytetare në Shqipëri.

Në 2014, shoqëria civile e lëvdoi nxjerrjen e ligjeve “Për njoftimin dhe konsultimin publik” dhe “Për të drejtën e informimit”. I cilësoi ato si zhvillime pozitive për procesin e demokratizimit dhe lehtësimin e pjesëmarrjes në vendimmarrje të aktorëve të shoqërisë civile.<sup>20</sup> Qeveria hartoi disa ligje të tjera dhe strategji për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe të drejtat civile, një përzgjedhje e të cilave jepet më poshtë.

17 Vurmo, Gjergji (2020), ‘Ligjet me porosi në Ballkanin Perëndimor: Kapje e maskuar e shtetit’, f. 7.

18 Komisioni Evropian (2020) Raporti për Shqipërinë 2020 (ang.), f. 28 ([https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf)).

19 Komisioni Evropian (2020), Raporti për Shqipërinë 2020, f. 10.

20 USAID (2015), Indeksi i qëndrueshmërisë së OShC-ve për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Euroazinë 2014 (ang.), f. 13 (<https://idmalbania.org/csosi-usaid-report-for-albania/>).



Tabela 1: Legjislacioni i nxjerrë gjatë viteve 2015-2020 që synon forcimin e hapësirës qytetare

Ligje	Strategji dhe plane veprimi
Ligji 119/2015 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile” i cili synon rritjen e pjesëmarrjes së sektorit civil në hartimin e legjislacionit që qeveris sektorin dhe në forcimin e demokracisë.	Udhërrëfytes për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2015 Udhërrëfytes për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019 – 2023
Ligji 45/2016 “Për vullnetarizmin” i advokuar nga OShC-të, i cili synon rregullimin dhe lehtësimin e aktit të vullnetarizmit.	Udhërrëfytes për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2015 Udhërrëfytes për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019 – 2023
Ligji 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë” që rregullon përpjekjet e shoqërisë civile në drejtim të ofrimit të shërbimeve dhe punës në komunitet.	Udhërrëfytes për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2015 Udhërrëfytes për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019 – 2023
Ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” dhe ligji 22/2018 “Për strehimin social”, ku përfitues janë viktimat e dhunës në familje, grupet e paavantazuara, etj. Ligji 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” që asiston në veçanti grupet e mënjanuara në të drejtën e tyre për një proces të drejtë gjyqësor.	Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015–2020 Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2016-2020 Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020 Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2016-2020 Plani Kombëtar i Veprimit për Personat LGBTI 2016-2020
Ligji 75/2019 “Për rininë” që synon përmirësimin e aktivizimit	Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015 - 2020

Ligje	Strategji dhe plane veprimi
dhe pjesëmarrjes së rinisë në shoqëri dhe mbështetjen e zhvillimit të OShC-ve rinore.	
Ligjet me amendimet e Kodit të Familjes, Kodit të Punës, Kodit Penal.	Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020 Strategjia e Drejtësisë për të Mitur dhe Plani i Veprimit 2018-2021

Megjithatë zbatimi i legjislacionit ka qenë problematik dhe i ngadaltë. Efektet pozitive të legjislacionit në forcimin e hapësirës qytetare janë ngadalësuar dhe përmirësimet në praktikë nuk qenë të dukshme në masën e dëshiruar gjatë viteve 2015-2020. Intervistat me aktivistë të shoqërisë civile japin një sërë arsyesh që shpjegojnë se përse rezultatet kanë qenë joinkurajuese. Ato lidhen me zbatimin e dobët të ligjeve, por edhe me përgatitjen e tyre të nxituar që anashkalon konsultimin publik.

Zbatimi efektiv i ligjeve të nxjerra është penguar nga mos harmonizimi i tyre duke shkaktuar përplasje ligjore gjatë procesit të aplikimit. Shembuj të rëndësishëm për rastin janë ligji nr. 91/2019 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligji nr. 92/2019 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar që njihen më mirë si paketa anti-shpifje. Ato u kthyen për rishqyrtim nga Presidenti i Republikës me arsyetimin e shkeljes së kushtetutës.<sup>21</sup> Komisioni i Venecias i gjykoj ndryshimet si të paqarta dhe të pazbatueshme në formën e tyre aktuale.<sup>22</sup> Një tjetër rast kyç është ligji 8773, më 23.4.2001 “Për tubimet”, neni 5, i cili u kërkon protestuesve të njoftojnë me shkrim Policinë e Shtetit për rrethanat e protestës. Kodi Penal në anën tjetër, neni 262 kërkon marrjen e lejes nga Policia e Shtetit për secilën protestë. Në praktikë, kjo përplasje ligjore ka shkaktuar kriminalizimin e shumë protestave. Problemi nuk u adresua nga shumica qeverisëse gjatë viteve 2015-2020, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme nga aktorët e shoqërisë civile.

21 Presidenti i Republikës (2020), ‘Dekret për kthimin e ligjit nr. 91/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Shqipëri” të ndryshuar”, 12 janar (<http://president.al/presidenti-meta-dekreton-kthimin-per-rishqyrtim-ne-kuvend-te-ligjit-nr-91-2019-arsyet-e-kthimit-per-rishqyrtim-te-ligjit/>); Presidenti i Republikës (2020), ‘Dekret për kthimin e ligjit nr. 92/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”, 12 janar (<https://president.al/presidenti-meta-dekreton-kthimin-per-rishqyrtim-ne-kuvend-te-ligjit-nr-92-2019-arsyet-e-kthimit-per-rishqyrtim-te-ligjit/>).

22 European Commission for Democracy through Law (2020), ‘Shqipëria – Opinion për projektamendimet e ligjit nr. 97/2013 për median audiovizive’ (ang.), Strasburg, 19 qershor f. 18 ([https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2020\)013-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2020)013-e)).

Ligjet janë miratuar dhe amenduar brenda një kohe shumë të shkurtër dhe nuk janë zbatuar ende. Kjo ndodh në rastin e ligjit 163/2014 “Për urdhrin e punonjësve socialë në Republikën e Shqipërisë”. Ai u miratua në 2014, u rimiratua në 2017 pas disa ndryshimeve dhe prapë, Urdhri për Punonjës Social nuk është themeluar ende në Shqipëri. Saga e amendimeve vazhdon sërish teksa kuvendi parasheh që të ketë ndryshime të reja ligjore në fund të 2020 dhe 2021.<sup>23</sup>

Anashkalimi i procesit të konsultimit publik ka rritur nevojën për ndryshime ligjore, gjë që ka shtuar mbiprodhimin e ligjeve dhe për rrjedhojë, ka vonuar zbatimin e tyre. Sipas gjetjeve të *Monitorimit të Reformës së Administratës Publike 2019-2020*<sup>24</sup>, jo të gjitha projektligjet ose projekt strategjitë kanë kaluar në konsultim publik, edhe pse e kanë pasur detyrim ligjor. Një raport i përgatitur në 2019 nga *ResPublica* tregon se gjysma e projektligjeve që janë kaluar nga kuvendi nuk janë konsultuar me publikun. Në anën tjetër, sipas ligjit për konsultimin publik projektligjet e ndërmarra nga deputetët që përbëjnë thujse një të tretën e të gjitha akteve legjislative, janë të përjashtuara nga procesi i konsultimit publik.<sup>25</sup> Kjo praktikë e dobëson procesin e ligjërjes, zbatimin dhe vetë sundimin e ligjit në tërësi.

Mungesa ose mosnxjerrja e akteve të mjaftueshme nënligjore e ka penguar zbatimin e ligjit gjithashtu. Për shembull, ligji 45/2016 “Për vullnetarizmin” që u miratua në 2016 u bë i zbatueshëm veç në 2019, pasi u miratuan aktet nënligjore.<sup>26</sup> Në anën tjetër, mbizotërimi i akteve nënligjore p.sh. Vendimet e Këshillit të Ministrave (VKM) mbi ligjet, apo edhe mbi kushtetutën ka pasur efekte përkeqësuese në hapësirën qytetare. Rastet më të dallueshme janë aktet normative që u nxorën gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore pas tërmetit 2019 dhe krizës së COVID-19 në 2020. Këto akte pezulluan të drejtat civile dhe politike të qytetarëve.

Teksa ekzekutivi ka qenë shumë efikas në hartimin e legjislacionit të miratuar, ai është përgjegjës për zbatimin e dobët të tij. Kjo lidhet me mungesën ose pamjaftueshmërinë e garantimit të mekanizmave funksionale për jetësimin e ligjeve,

---

23 Carcani-Mane, Valbona (2020), ‘Shqipëri – Sesioni i dëgjjesës parlamentare për ligjin për Urdhrin e Punonjës Social në Shqipëri’ (ang.), Child Protection Hub (<https://childhub.org/en/child-protection-news/albania-parliamentary-hearing-session-law-order-social-work-albania>).

24 Bazuar në gjetjet paraprake të Monitorimit të RAP-së në Shqipëri 2019/2020, pjesë e projektit Fuqizimi i Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor për një Administratë Publike të Reformuar – WEBER 2.0. Raporti pritet të publikohet në qershor 2021. Për më shumë informacion vizito <https://www.par-monitor.org/>.

25 Matlija, Dorian dhe Irena Dule (2019), ‘Konsultimi publik në Shqipëri 2017-2018’, ResPublica, f. 53 (<http://www.respublica.org.al/wp-content/uploads/2019/04/Konsultimi-Publik-2017-2018-Res-Publica-NED.pdf>).

26 USAID, ICNL, fhi360 (2019), ‘Indeksi i qëndrueshmërisë së OShC-ve për Evropën Qëndrore dhe Lindore dhe Euroazinë 2018, shtator, f. 2 (<https://idmalbania.org/csosi-usaid-report-for-albania>).



të fondeve të alokuara për zbatimin e politikave, të trajnimit të stafit të administratës publike dhe të ndarjes së praktikave më të mira se si të implementohen politikat.<sup>27</sup>

Burimet e pamjaftueshme të alokuara për zbatimin e strategjive të ndryshme kombëtare e planeve të veprimit dhe mungesa e progresit drejt implementimit të tyre janë vënë në pah në vazhdimësi nga Raportet e Progresit të KE-së. Duke cituar raportin e 2020 “zbatimi efektiv i strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit për barazinë gjinore 2016-2020 është penguar nga mungesa e qëndrueshme e financimit”, ose “plani kombëtar i veprimit për personat LGBTI i cili përfundon në 2020 nuk prodhoi rezultate të dukshme, pjesërisht edhe prej mungesës së burimeve financiare.” Për të vazhduar me “planin kombëtar të veprimit 2016-2020 për integrimin e romëve dhe egjiptianëve, që pavarësisht se është në vitin e fundit të zbatimit ka pasur progres të kufizuar.”<sup>28</sup> Për pasojë, zbatimi joefektiv i strategjive që synojnë forcimin e hapësirës qytetare bëhet një praktikë dobësuese, për sa kohë nuk ia arrin të forcojë të drejtat e njeriut dhe ato civile mes anëtarëve dhe grupeve të shoqërisë.

*Raporti i 2015 nga KE-ja* vëzhgoi se “[...] kuadri ligjor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut është përgjithësisht brenda standardeve evropiane. Gjithsesi, zbatimi efektiv i legjislacionit përkatës dhe strategjive është i kufizuar dhe zbatimi i mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut mbetet i pamjaftueshëm.”<sup>29</sup> Ky qëndrim mbahej ende nga aktivistët e intervistuar nga shoqëria civile. Sidoqoftë, Komisioni Evropian ka vërejtur përparim në kuadrin ligjor. Ajo çka më herët quhej ‘zbatim i kufizuar i strategjive dhe mekanizma të pamjaftueshëm’, evoluoi gjatë viteve 2016-2020 në ‘mekanizmat mbeten për t’u forcuar’. Ndërsa që prej 2018, raportet e KE-së vlerësuan se legjislacioni është tashmë brenda standardeve evropiane.<sup>30</sup> Ndryshe nga vitet 2015-2018 të cilat sinjalizuan progres në legjislacion dhe zbatimin e tij, raportet

---

27 Intervista me aktivistë të shoqërisë civile.

28 Komisioni Evropian (2020) Raporti për Shqipërinë 2020, f. 36-37.

29 Komisioni Evropian (2015) Raporti për Shqipërinë 2015 (ang.), [Bruksel, SWD (2015) 213 final], 10 nëntor, f. 5, ([https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_albania.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2015/20151110_report_albania.pdf)).

30 Komisioni Evropian (2016) Raporti për Shqipërinë 2016 (ang.), [Bruksel, SWD (2016) 364 final], 9 nëntor, f. 5

([https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2016/20161109\\_report\\_albania.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf)); Komisioni Evropian (2018) Raporti për Shqipërinë 2018 (ang.), [Strasburg, SWD (2018) 151 final], 17 prill, f. 6 (<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>); Komisioni Evropian (2019) Raporti për Shqipërinë 2019, [Bruksel, SWD (2019) 215 final], 29 maj, f. 4;

(<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>); Komisioni Evropian (2020), Raporti për Shqipërinë 2020, f. 6.

e viteve 2019-2020 nuk përmendin përparime të mëtejshme të mekanizmave që mundësojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në mbyllje, hartimi i legjislacionit për të drejtat e njeriut dhe të drejtat civile mund ta forcojë hapësirën qytetare në parim. Qeveria e Shqipërisë ka qenë shumë e suksesshme në nxjerrjen e legjislacionit gjatë viteve 2015-2020. Veçse mbiprodhimi i ligjeve, një pjesë e të cilave nuk u harmonizuan me njëra-tjetrën dhe pjesa më e madhe nuk u mbështetën nga nxjerrja e të gjitha akteve të nevojshme ligjore-administrative, ose nga burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare ka shkaktuar probleme në zbatimin e tyre gjatë periudhës së studiuar. Në anën tjetër, numri i madh dhe hartimi i shpejtë i legjislacionit të nxjerrë nga kuvendi ka kërkuar amendime të tjera, që i ka bërë normat ligjore shumë të paqëndrueshme. Në vend se të forcojnë hapësirën qytetare, këto praktika rezultojnë të kenë një ndikim negativ prej shtyrjes ose zbatimit të pjesshëm të tyre. E njëjta logjikë vlen edhe për strategjitë, planet e veprimit e udhërrëfyesit që kanë mbetur të zbatuara pjesërisht gjatë viteve 2015-2020, çka nuk i ka sjellë përmirësime qëndrueshmërisë dhe konsolidimit të hapësirës qytetare në vend.

## **Ngecja e progresit drejt mjedisit mundësues për shoqërinë civile**

Shumë organizata të shoqërisë civile në Shqipëri festuan 20 vjetorin e krijimit në 2020. Si aktorë civilë, aktivitetet e tyre kanë ndihmuar në zhvillimin e hapësirës qytetare prej viteve '90. Statusi i tyre si ndërmjetësues ndërmjet qytetarëve dhe politikëbërësve dhe si një faktor kyç në procesin e demokratizimit e të integritimit të vendit, është pranuar nga palët shtetërore dhe është inkurajuar nga donatorët ndërkombëtarë. Ndërkohë, OShC-të kanë ndërtuar mekanizma dhe raporte monitorimi për të vlerësuar mjedisin ku ato operojnë dhe për të përmirësuar qëndrueshmërinë e tyre. Këto raporte tregojnë se vështirësitë kanë qenë të vazhdueshme dhe e kanë penguar aktivitetin e këtij sektori përgjatë viteve 2015-2020. Në përgjithësi OShC-të ia kanë dalë të punojnë, pavarësisht një mjedisi të pafavorshëm.

Në 2015 parlamenti i Shqipërisë miratoi me sukses ligjin I 19/2015 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile”, një trup konsultues për të ndihmuar qeverinë në zhvillimin e sektorit civil. Ky ligj u ndoq nga miratimi i Udhërrëfyesit për hartimin e politikës dhe masave për një mjedis mundësues për shoqërinë civile, i viteve 2015-2019. Këto akte njohën në mënyrë institucionale rolin e organizatave të shoqërisë civile në forcimin e hapësirës qytetare në Shqipëri dhe në lehtësimin e bashkëpunimit dhe komunikimit me institucionet shtetërore në fushat e integritimit evropian, të drejtat e njeriut, sundimit të ligjit dhe demokratizimit. Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile dhe Udhëzuesi patën për qëllim krijimin e

kushteve për rregullimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë civile në Shqipëri si një aktore civile. Megjithatë *Raportet e Matricës së Monitorimit dhe Indeksi i Qëndrueshmërisë së Organizatave të Shoqërisë Civile* shfaqin shumë pak arritje pozitive në këtë drejtim. Këto arritje lidhen përgjithësisht me iniciativat advokuese<sup>31</sup> të OShC-ve, sesa me politikat qeverisëse.

Midis viteve 2016 dhe 2019, funksionimi i Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile është raportuar si i dobët sa i takon fuqisë së ndikimit dhe pa rezultate. Bazuar në *Raportin e Matricës së Monitorimit* ky dështim përbën një “mundësi të humbur për t’u angazhuar në dialog efektiv me qeverinë”.<sup>32</sup> I njëjti raport sinjalizoi regres në përfshirjen e shoqërisë civile në konsultimin e projektligjeve ose politikave për vetë sektorin, duke theksuar kufizimet e efektshmërisë së Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile.<sup>33</sup>

Në linja të ngjashme, dokumenti strategjik kryesor i qeverisë Udhërrëfyese për shoqërinë civile i viteve 2015-2019 shënoi pak ose aspak progres në pjesën më të madhe të masave të propozuara. *Indeksi i Qëndrueshmërisë së OShC-ve* vuri në pah se 80% e veprimeve të planifikuara në udhërrëfyes nuk ishin zbatuar.<sup>34</sup> Për shembull, procesi i gjatë dhe tejet burokratik i regjistrimit, çregjistrimit dhe ndryshimit të organeve ligjore të OShC-ve nga Gjykata e Rrethit Tiranë e cila u shërben të gjitha OShC-ve të Shqipërisë, ka mbetur i pandryshuar<sup>35</sup> që prej vitit 2015. Përgjatë vitit 2020, qeveria shpalli konsultimin publik të projektligjit mbi regjistrimin e OShC-ve. Në përgjithësi sektori civil i konsideroi pjesë të veçanta të projektligjit si problematike, të papërcaktuara dhe të paqarta. Ata shprehën shqetësim për shtimin e trysnisë dhe trembjes, si edhe për shkeljen potenciale të lirisë së organizimit,<sup>36</sup> që përbëjnë mundësi shtesë për tkurrjen e hapësirës qytetare.

---

31 Për shembull, në 2019 qeveria lëshoi një udhëzim për kthimin e TVSh-së për OShC-të që përfitojnë fonde të huaja nga donatorët, pas advokimit të suksesshëm të drejtuar nga Partners Albania. Zbatimi i tij është ende nën monitorim. Shih Hoxha, Juliana et al (2020), *Matrica e monitorimit të mjedisit mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile, Shqipëri 2019* (ang.), Tiranë: Partners’ Albania for Change and Development, f. 46, (<https://partnersalbania.org/publication/monitoring-matrix-on-enabling-environment-for-csos-development-country-report-for-albania-2019/>).

32 Hoxha, Juliana et al (2019), *Matrica e monitorimit të mjedisit mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile - Raporti për Shqipërinë, maj 2018-2019*, Tiranë: Partners’ Albania for Change and Development, f. 8 (<http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2019/07/Monitoring-Matrix-Country-Report-for-Albania-2018.pdf?fbclid=IwAR2GGIwWPKXUetYr6NQdVI-Y3dv4L-BQTWS1SPCfri1qcXwtvVzAEcKbyTw>).

33 Ibid, p. 30.

34 Azizaj, Evelina dhe Romario Shehu (2020), *Indeksi i Qëndrueshmërisë së Organizatave të Shoqërisë Civile për Shqipërinë 2019*, f. 2.

35 Ibid, f. 2.

36 Grup OShC-sh (2020) ‘Kërkesë për seancë dëgjimore me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile për projektligjin “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, 20 tetor, f. 2, 4

Në terma financiare, edhe pse OShC-të që përfitojnë nga fondet e Bashkimit Evropian përjashtohen ligjërisht nga TVSh-ja, problemet vazhdojnë gjatë zbatimit të skemës. Kalendarit për marrjen e rimbursimit i ka penguar më tej aktivitetet e OShC-ve. Për ta rënduar situatën më shumë, ligji 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” vendosi kërkesa të reja raportimi, duke rritur kështu barrën burokratike tek OShC-të. *Indeksi i Qëndrueshmërisë së OShC-ve* i vitit 2019 tregon se tani bankat u kërkojnë OShC-ve të paraqesin amendimet e statutit dhe proces-verbalet e mbledhjeve të bordit drejtues për të bërë transaksionet e pagesave të tyre, duke i vendosur OShC-të “nën një kontroll të shtuar”.<sup>37</sup>

Paqëndrueshmëria financiare ka mbetur një problem ngulmues përgjatë viteve 2015-2020, veçanërisht për OShC-të vendore. Pavarësisht rritjes që pati filantropia pas tërmetit të vitit 2019<sup>38</sup>, raporte të ndryshme<sup>39</sup> kanë vënë në pah mungesën e ligjeve që rregullojnë aktivitetet e bamirësisë dhe që do të siguronin incentiva fiskale për të mundësuar donacionet nga palët e treta në të mirë të aktiviteteve të OShC-ve.

Fondet publike vazhdojnë të jenë të limituara dhe jo transparente.<sup>40</sup> Për këtë arsye, aktivistët e intervistuar shprehin besim të ulët dhe janë kritikë ndaj rolit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC)<sup>41</sup>, e cila menaxhon fondet më të mëdha publike për OShC-të në vend. Sasia e fondeve publike të AMShC-së nuk ka ndryshuar përgjatë viteve 2015-2020<sup>42</sup> (101,000,000 lek në total për vit, për të gjitha thirrjet e projekteve). Në prag të shpërthimit të COVID-19, OShC-të kërkuan publikisht

---

([http://resourcecentre.al/wp-content/uploads/2020/10/Per-projektligjin-Per-Regjistrimin-e-OJFve\\_Nga-organizatat-e-shoqerise-civile\\_Final.pdf](http://resourcecentre.al/wp-content/uploads/2020/10/Per-projektligjin-Per-Regjistrimin-e-OJFve_Nga-organizatat-e-shoqerise-civile_Final.pdf)).

37 Azizaj, Evelina dhe Romario Shehu (2020) *Indeksi i Qëndrueshmërisë së Organizatave të Shoqërisë Civile për Shqipërinë 2019*, f. 5.

38 Hoxha, Juliana et al (2019), *Matrica e monitorimit të mjedisit mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile - Raporti për Shqipërinë Maj 2018-2019*, f. 22-23.

39 Hoxha, Juliana et al (2018), *Matrica e monitorimit të mjedisit mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile - Raporti për Shqipërinë 2017* (ang.), Tiranë: Partners' Albania for Change and Development, f. 8 (<http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2018/07/Monitoring-Matrix-report-for-Albania-2017.pdf>); Hoxha, Juliana et al (2019), *Matrica e monitorimit të mjedisit mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile - Raporti për Shqipërinë maj 2018-2019*, f. 46.

40 Konstatuar nga shumë intervista me aktivistë të OShC-ve dhe raporte. Për shembull shih Hoxha, Juliana et al (2019), *Matrica e monitorimit të mjedisit mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile - Raporti për Shqipërinë maj 2018-2019*, f. 26; Komisioni Evropian (2020) *Raporti për Shqipërinë 2020*, f. 14.

41 Vurmo, Gjergji dhe Orsiola Kurti, (2014), ‘Me e sjellë AMShC-në më pranë shoqërisë civile’, *Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim*, dhjetor ([https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2017/02/AMSHC-paper\\_ENG.pdf](https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2017/02/AMSHC-paper_ENG.pdf)).

42 Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, ‘Raporte monitorimi’, (<http://www.amshc.gov.al/web/raporte/monitorimi/>).

mbështetje më të madhe qeveritare.<sup>43</sup> Qeveria jo vetëm që nuk e miratoi këtë kërkesë, por thajse e përgjysmoi buxhetin e AMShC-së dhe i rialokoi këto fonde në sektorë të ndryshëm shtetërorë, në përgjigje të krizës së shkaktuar nga COVID-19. Buxheti për shoqërinë civile në vitin 2020 u bë 61,000,000 lek,<sup>44</sup> që përbën buxhetin më të ulët në periudhën 2015-2020. Ulja e fondeve është një manifestim i politikave qeveritare tkurrëse të hapësirës qytetare. Nga ana tjetër, ky reduktim dobësoi rolin e vetë Agjencisë në forcimin e sektorit civil përgjatë vitit 2020, në kohën kur sektori kishte më së tepërmi nevojë për mbështetjen dhe drejtimin e saj.

Pas përfundimit të afatit kohor të udhërrëfyesit në 2019, qeveria miratoi *Udhërrëfyesin* e rishikuar për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019 – 2023. OShC-të morën pjesë në konsultimin e projekt dokumentit. *Raporti* i KE-së për vitin 2020 theksoi se “zbatimi [i tij] varet goxha nga fondet e donatorëve”.<sup>45</sup> Nga ana tjetër, OShC-të kanë pritshmëri të ulëta për aplikimin e Udhërrëfyesit 2019-2023,<sup>46</sup> duke këmbëngulur se moszbatimi i strategjive nuk lehtëson zhvillimin e tyre, e për pasojë tkurr hapësirën qytetare.

*Indeksi i Qëndrueshmërisë së OShC-ve* ka raportuar për përmirësime shumë të vogla të sektorit civil përgjatë viteve 2015-2020. Ky Indeks vlerëson qëndrueshmërinë e OShC-ve në shtatë dimensione. Bazuar në të dhënat e publikuara në tabelën 1,<sup>47</sup> OShC-të kanë përparuar pavarësisht një mjedisi sfidues. Ato kanë konsoliduar kapacitetet organizative dhe kanë përmirësuar pak qëndrueshmërinë financiare. Advokimi ka përparuar ngadalë. Infrastruktura e sektorit dhe ofrimi i shërbimeve janë përmirësuar gjithashtu. Vitet 2018-2019 janë periudha më pozitive për qëndrueshmërinë e OShC-ve, pasi shumica e dimensioneve kanë shënuar përparim të lehtë, me përjashtim të mjedisit ligjor dhe imazhit publik. Të dhënat tregojnë se

---

43 Newsbomb (2020), ‘Organizatave të shoqërisë civile letër Ramës: Kërkojmë mbështetje financiare’, 24 mars (<https://www.newsbomb.al/organizatat-e-shoqerise-civile-leter-rames-kerkojme-mbeshtetje-financiare-kane-ngelur-jashte-paketes-ekonomike-grupet-sociale-me-ne-nevoje-letra-e-plote-199860>).

44 Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (2020), ‘Treguesit e buxhetit të katër mujorit të II të vitit 2020 për institucionin AMShC’, nr. prot. 249, 22 shtator

([http://www.amshc.gov.al/web/raporte/monitorimi/2020/Raporti\\_per\\_4-mujorin\\_2\\_te\\_vitit\\_2020.pdf](http://www.amshc.gov.al/web/raporte/monitorimi/2020/Raporti_per_4-mujorin_2_te_vitit_2020.pdf)).

45 Komisioni Evropian (2020) *Raporti për Shqipërinë 2020*, f. 13.


46 Azizaj, Evelina dhe Romario Shehu (2020) *Indeksi i qëndrueshmërisë së organizatave të shoqërisë civile për Shqipërinë 2019*, f. 2.

47 *Indeksi i qëndrueshmërisë së organizatave të shoqërisë civile* është një indeks i përvitshëm i zhvilluar nga USAID dhe i zbatuar nga IDM Albania, si partner lokal që prej vitit 2010. Vlerësimet e Indeksit të qëndrueshmërisë së OShC-ve janë të bazuara në një shkallë prej 1.0-7.0, ku 1.0 nëkupton qëndrueshmërinë më të arriturë dhe 7.0 qëndrueshmërinë më të penguar. Specifikisht, 1.0-3.0 tregojnë qëndrueshmëri të arritur; 3.1-5.0 qëndrueshmëri në evolucion; 5.1-7.0 qëndrueshmëri të penguar. Lista e plotë e raporteve qaset në <https://idmalbania.org/csosi-usaid-report-for-albania/>



mjedisi ligjor nuk ka përparuar që prej vitit 2016. Avancimet e fundit në qëndrueshmërinë financiare dhe advokim datojnë në 2018 dhe i vetmi dimension i cili ka ngecur që prej vitit 2015 është imazhi publik. Dimensionet të cilat mbështeten drejtpërdrejtë në përpjekjet autonome të OShC-ve si p.sh. infrastruktura sektoriale, ofrimi i shërbimeve dhe kapaciteti organizativ kanë përparuar përgjatë viteve 2018-2019. Ndërkohë, dimensionet të cilat janë të lidhura drejtpërsëdrejti me politikat qeveritare dhe perceptimin e publikut, e kanë më të vështirë të përparojnë.

Grafiku I: Indeksi i Qëndrueshmërisë së Organizatave të Shoqërisë Civile përgjatë viteve 2015-2019



Burimi: Indeksi i Qëndrueshmërisë së Organizatave Civile (USAID, FHI 360, IDM Albania) 2015; 2016; 2017; 2018; 2019.

Përmirësimet e OShC-ve në sektorin civil përgjatë pesë viteve të fundit duket se janë më të lidhura me donatorët e huaj dhe vetë përpjekjet e OShC-ve,<sup>48</sup> sesa me politikat qeveritare. Programet e tyre për ngritjen e kapaciteteve kanë nisur të nxjerrin rezultate të dukshme dhe tani sektori po rritet si një trup organik normal që fiton pjekuri duke u përballur me sfida.<sup>49</sup> Organizimi i pavarur i OShC-ve përparoi gjithaq me themelimin e Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri në vitin 2019. Qendra shërben si një platformë informimi e ofrimi shërbimesh për OShC-të dhe financohet nga donatorë të huaj. Brenda pak muajsh aktivitet, aktivistët e intervistuar besonin në rëndësinë dhe rolin e kësaj qendre, e


48 Azizaj, Evelina dhe Romario Shehu (2020) *Indeksi i qëndrueshmërisë së organizatave të shoqërisë civile për Shqipërinë 2019*, f. 3-4.

49 Bazuar në një intervistë me një aktivist të shoqërisë civile.

cila duket se ka frymëzuar më shumë besim sesa Agjencia shtetërore për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.<sup>50</sup>

Perceptimi i publikut për aktivitetin e OShC-ve është rritur gjithashtu që prej vitit 2015 (shih tabelën 2). Niveli më i lartë i besimit u arrit në 2017-2018 dhe ka qëndruar pothuajse konstant për tre vite rresht, nga viti 2017 deri në 2019. Përgjithësisht publiku merr me mend se ndikimi politik është i ulët nëpër OShC. Perceptimi më i lartë u vu re në vitin 2017, që përkoi me vitin e zgjedhjeve të përgjithshme, ndërsa në vitet e tjera trendi ulet. Për sa i përket aftësisë së OShC-ve për ta bërë qeverinë të mbajë përgjegjësi, perceptimi publik tregon se OShC-të kanë qenë efektive në përpjekjet e tyre mbikëqyrëse. Perceptimi i tyre mbi aftësinë për të vënë nën presion institucionet publike është përmirësuar nga 2015 në 2017, kur 51% e të anketuarve besonin në fuqinë e OShC-ve për ta bërë qeverinë të përgjegjshme. Prej 2018 të dhënat kanë rënë lehtë. Ato përkojnë me perceptimin e publikut për rritjen e papërgjegjshmërisë së vetë qeverisë. Sipas raporteve të *Besimit në Qeverisje* të viteve 2017-2020, 61% e të anketuarve besonin se qeveria nuk jepte llogari në vitin 2017. Shifra u rrit në 63% në 2018, 65% në 2019 dhe 64% në 2020<sup>51</sup>, që përkon me perceptimin për presionin e dobësuar që vjen nga OShC-të.

Grafiku 2: Perceptimi i publikut për OShC-të përgjatë 2015-2020



Burimi: Sondazh i opinionit publik *Besimi në Qeverisje* (IDM, UNDP) 2015; 2016; 2017; 2018; 2019; 2020.

Në përfundim, përmirësimet e qëndrueshmërisë së organizatave të shoqërisë civile përgjatë pesë viteve të fundit kanë ardhur më shumë si pasojë e rritjes së tyre të natyrshme, përpjekjeve të tyre të pavarura dhe mbështetjes së donatorëve, sesa si rezultati i kuadrit ligjor e politikave. Siç u tregua më lart, me kalimin e kohës ky

50 Bazuar në konstatime intervistash me aktivistë të shoqërisë civile.

51 Raportet e sondazhit *Besimi në Qeverisje* gjenden në <https://idmalbania.org/trust-in-governance/> Shifrat e cituara i referohen faqeve të raporteve vjetore si në vijim: 2017: f. 31, 2018: f. 38, 2019: f. 53, 2020: f. 47.

kuadër ka sjellë pengesa gjithnjë e më shumë. Pavarësisht iniciativave ligjore pozitive që u ndërmorën në 2015, qeveria nuk ka arritur t'i zbatojë politikat specifike që krijojnë një mjedis mundësues për funksionimin e shoqërisë civile. Institucionet publike zbatuan vetëm 20% të masave të parashikuara nga Udhëzuesi 2015-2019 për shoqërinë civile dhe sektori civil nuk ka besim as një zbatimin e Udhëzuesit 2019-2023. Politikat qeveritare kanë dështuar për të gjetur zgjidhje konkrete për problemet që janë ngritur nga sektori e në anën tjetër, ato kanë rritur kontrollin dhe intimidimin. Praktikrat me politikrat bashkë kanë kontribuar në tkurrjen e hapësirës qytetare në Shqipëri, që ka kulmuar në vitet 2018-2020.

## Spastrimi i medias dhe reforma e paketës anti-shpifje

Paketa anti-shpifje ka qenë përpjekja më e madhe, por jo e fundit<sup>52</sup>, për të disiplinuar median përgjatë viteve 2015-2020. Shumë nisma dhe praktika patën si qëllim t'i tregonin medias si të sillej. Gama e tyre shkon nga kryeministri që u mësonte gazetarëve si të mos bënin pyetje shqetësuese,<sup>53</sup> deri tek mbyllja e mediave kritike. Sulmet e njëpasnjëshme midis viteve 2015-2017 dhe sërish midis 2017-2020 përbëjnë dy valë të intimidimit të medias që ndjekin të njëjtin model. Ato nisën me propozimin për legjislacionin kundër shpifjes në vitin 2015, u pasuan nga shkarkimi i gazetarëve me qëndrime kritike, mbyllja e transmetuesve kritikë, akuzat për pastrim parash, konfiskimi i mediave dhe kulmuan kur kuvendi miratoi paketën antishpifje në 2019-2020. Pjesa e mëposhtme përmbledh një sërë politikash dhe praktikash qeveritare kundrejt medias, që kanë penguar kontributin e këtij aktori civil në shoqëri dhe në hapësirën qytetare, duke shkaktuar tkurrjen e hapësirës qytetare.

Në vitin 2015 shumica parlamentare në pushtet filloi procedurat ligjore për dhënien e dënimeve me burg për shpifjet ndaj zyrtarëve publikë. Në fund, reagimi i fortë kundërshtues nga organizatat ndërkombëtare çoi në tërheqjen e projektligjit.<sup>54</sup> Megjithatë reagimet e tilla nuk qenë të mjaftueshme për të ndaluar mbylljen e *Agon Channel*, një stacion televiziv kritik ndaj qeverisë. Akuza për pastrim parash e cila u përdor për të justifikuar këtë mbyllje rezultoi e pabazuar në gjyq, “që i kushtoi shtetit

---

52 Lexo më shumë në Exit News (2020b), ‘Politikanët i bënë presion medias që të mos i bashkohet platformës së vetërregullimit ‘Aleanca e Vetërregullimit për Media Etike’ (ang.), 19 nëntor (<https://exit.al/en/2020/11/19/cukali-politicians-pressured-media-into-not-joining-self-regulation-platform-ethical-media-alliance-self-regulation/>).

53 Exit News (2018b) ‘Gazetarja refuzon të zbrapset, Rama ndalon konferencën për shtyp’ (ang.), 18 maj (<https://exit.al/en/2018/05/18/journalist-refuses-to-back-down-rama-breaks-off-press-conference/>)

54 OSBE (2015), ‘Shqipëria duhet ta refuzojë projektligjin që propozon burgosje për shpifje ndaj zyrtarëve publikë’ (ang.), Viena, 12 nëntor (<https://www.osce.org/fom/199446>).

të varfër miliona euro në tarifa ligjore”.<sup>55</sup> Disa precedentë u regjistruan në vitin 2016 gjithashtu. Në këtë kohë, media televizive kombëtare *Vizion Plus* ndërpreu transmetimin e serialit televiziv të llojit dokumentar investigativ, *Publicus*. Zyra e Informacionit e Delegacionit të Bashkimit Evropian në 2017 i dha regjisorit të serialit çmimin e dytë për Gazetari Investiguese. Duke lënë të kuptohet se seriali u mbyll me urdhër politik, regjisorin shpjegoi se qeveria nuk e kishte problemin me lirinë e shprehjes për se. Ajo shërben si një tregues i nivelit të demokracisë dhe lejohet për sa kohë që prodhimet e medias nuk kanë përmbajtje kritikuese. Nëse media i argumenton me prova veprimet e gabuara të qeverisë, ajo kthehet në një kërcënim.<sup>56</sup> Trendi vazhdoi në 2017, por këtë rradhë objektivi u zhvendos tek individët. Brenda një jave, menaxherët e dy mediave nuk i rinovuan kontratat e punës për dy ekzekutivë të shquar mediash. Gazetarët e shkarkuar u shprehën se menaxherët zgjodhën të adoptonin politika redaksionale që favorizonin qeverinë, duke vepruar kështu kundër parimeve të gazetarisë.<sup>57</sup> Në 2019, pas ekspozimit mediatik të një mashtrimi infrastrukturor me fondet publike dhe qasjes së tyre kritikuese, menaxherët e televizionit mbyllën dy programe të tjera, *Të paeksponuarit* dhe *A show*, me justifikimin e “reformës së brendshme”.<sup>58</sup> Në 2020 autoritetet publike gjobitën dhe kërcënuan me mbyllje RTV Ora, për shkak të thyerjes së protokollit kundër COVID-19 gjatë një transmetimi.<sup>59</sup> Në atë kohë, kjo media ishte pozicionuar aktivisht kundër politikave të qeverisë për shkatërrimin e Teatrit Kombëtar. Pronari i medias kritike u përball me akuza të pastrimit të parave dhe institucionet e shtetit konfiskuan asetet e tij të Yldon Media Group.

Kulmi arriti në vitin 2019 dhe në hyrje të 2020 kur shumica parlamentare miratoi amendamentet e paketës anti-shpifje, të cilat u kundërshtuan nga media dhe aktorët civilë. Për të ndrequr situatën dhe në mbështetje të protestës së shoqatave të gazetarëve, Komisioni Evropian kërkoi <sup>60</sup> rishikimin e paketës, bazuar në

---

55 Daragahu, Borzohu (2019), ‘Në fillim ata erdhën për emisionin e mëngjesit: Si e mbylli qeveria e Shqipërisë një stacion televiziv të tërë që guxoi ta kritikojë’ (ang.), *Independent*, 15 shtator (<https://www.independent.co.uk/news/world/europe/albania-agon-tv-press-freedom-censorship-corruption-francesco-becchetti-a9103496.html>).

56 Bazuar në Exit News (2017), ‘Artan Rama dhe Publicus fitojnë çmimin e dytë të Gazetarisë Investigative’, 9 qershor (<https://exit.al/artan-rama-dhe-publicus-fitojne-cmimin-e-dyte-te-gazetarise-investigative/>).

57 Agolli, Ilirian (2017), ‘Tiranë: Largohen nga puna gazetarë të njohur’, *Zëri i Amerikës*, 12 janar (<https://www.zeriamerikes.com/a/alfred-lela-armand-shkullaku-largime-nga-puna-media/3673675.html>).

58 Karaj, Vladimir (2019) ‘Mbylljen emisionet e fundit kritike ndaj qeverisë shqiptare’ (ang.), *BalkanInsight* 29 gusht (<https://balkaninsight.com/2019/08/29/last-tv-shows-critical-of-the-government-are-closed-down-in-albania/>).

59 Ora News (2020), ‘Skandal, ISSh kërkon mbylljen e sinjalit të RTV Ora’, 15 maj (<https://www.oranews.tv/article/skandal-ishsh-kerkon-mbylljen-e-sinjalit-te-rtv-ora>). Autoriteti i Medias Audiovizive reagoi dhe sqaroi se nuk kishte qëllim të mbyllte median. Lexo më shumë tek Autoriteti i Mediave Audiovize (2020), ‘Njoftim për mediat’, 15 maj (<http://ama.gov.al/2020/05/15/njoftim-per-mediat/>).

60 Komisioni Evropian (2020) *Raporti për Shqipërinë 2020*, f. 30.

rekomandimet e mundësuar nga Komisioni i Venecias, nisur nga kërkesa e Këshillit të Evropës. *Raporti i Progresit i KE-së* deklaroi se amendamentet “dështuan t’i përmbaheshin standardeve ndërkombëtare dhe parimeve të lirisë së medias dhe ngritën shqetësime për shtimin e censurës dhe vetëcensurës si dhe zbrapsjen potenciale të lirisë së shprehjes në vend”.<sup>61</sup>

Në një mjedis të këthillë, gjuha e ashpër ndaj gazetarëve ka qenë e zakonshme,<sup>62</sup> ndërsa intimidimet dhe sulmet nga pushteti ekzekutiv kanë ardhur duke u rritur. Të drejtat sociale dhe të punës të gazetarëve nuk janë respektuar plotësisht përgjatë viteve 2015-2020. Informaliteti i punës është akoma prezent e shkakton pasiguri në punë.<sup>63</sup> Sipas një raporti të BIRN-së në 2015,<sup>64</sup> media shqiptare ka përjetuar nivele shqetësuese të censurës. Kjo është shkaktuar nga presioni i institucioneve përmes reklamimeve të sponsorizuara nga shteti, reklamuesve të mëdhenj dhe interesave ekonomike të pronarëve të mediave që reflektohen tek politika redaksionale. Censura manifestohet në vendime për të shmangur mbulimin e lajmeve të caktuara dhe përfshin “mbulim pozitiv/ marrëdhënie publike (PR) të partnerëve financiarë dhe politikë”, gjë që shkurajon ose asgjëson gazetarinë investigative dhe kritikuese. Raporti shënon se një fenomen tjetër i përhapur dhe shqetësues është vetëcensura gazetareske që vjen prej interesave politike dhe ekonomike të pronarëve të medias, mungesës së sigurisë fizike dhe sigurisë së punës. Një përshkrim i ngjashëm është raportuar nga *Raporti i KE-së për Shqipërinë në 2020*.<sup>65</sup> Raporti *Vendet në Tranzicion 2018* dha vëzhgime të përafërta për “atë çfarë duket në pamje të parë si sektori i gjallë i medias”, por që në praktikë funksionon më shumë si një “zgjatim i interesave politike dhe ekonomike nga të cilat finançohet, sesa si rojtare që i kërkon llogari pushtetit”.<sup>66</sup> Këto praktika kanë vazhduar në vitet 2019 dhe 2020, pavarësisht këmbënguljes së ca profesionistëve të medias që refuzuan të nënshtrohen. Këta të

---

61 Ibid.

62 Për disa nga rastet e diskriminimit gjinor referoju <https://politiko.al/ske-faj-qe-sje-pergatitur-ilva-tare-flet-per-ndodhine-me-edi-ramen/> Për intimidimin dhe kërcënimin e gazetarëve referoju <https://kshhm.al/en/2020/08/18/amc-protests-against-the-insulting-and-threatening-messages-towards-the-journalist-beti-njuma-by-the-mayor-of-tirana/> Për një pamje të përgjithshme të detyrimeve për të drejtat e njeriut referoju <https://exit.al/en/2019/06/21/international-media-freedom-delegation-albania-not-meeting-human-rights-obligations/>

63 Përgjatë krizës së COVID-19, më shumë se 40 gazetarë humbën punën dhe rreth 30% pësuan ulje page. Lexo më shumë tek Gërguri, Dren (2020), ‘Çipa: Media pësoi goditje të rëndë nga pandemia, mbi 40 gazetarë humbën vendin e punës ndërkaq rreth 30% e gazetarëve pësuan ulje të pagave’, Portalb, 25 qershor (<https://portalb.mk/691471-cipa-media-pesoi-goditje-te-rende-nga-pandemia-mbi-40-gazetare-humben-vendin-e-punes-nderkaq-rreth-30-e-gazetareve-pesuan-ulje-te-pagave/>).

64 Halo, Adela et al (2015), *Të mbyllësh një sy ndaj lajmit: vetëcensura në median shqiptare* (ang.), Tiranë: BIRN, f. 6 (<https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2017/05/Report-on-self-censorship-in-the-Albanian-media.pdf>).


65 Komisioni Evropian (2020) *Raporti për Shqipërinë 2020*, f. 31.

66 Kajsio, Blendi (2018), ‘Vendet në tranzicion 2018 – Shqipëria’.

fundit vazhduan të bëjnë investigime me cilësi të lartë dhe rritën kësisoj vëmendjen e donatorëve ndaj përpjekjeve të tyre.<sup>67</sup>

Përgjatë viteve 2015-2020, qeveria dhe institucionet publike kanë përdorur praktika të reja të cilat u bënë dominuese dhe normale në vitet 2019-2020.<sup>68</sup> Në vend se të ftojë mediat në aktivitetet e saj, qeveria u shpërndan video marrëdhëniesh publike gati për publikim. Qeveria ka ulur ndjeshëm numrin e konferencave të shtypit dhe i ka zgjedhur paraprakisht me kujdes gazetarët pjesëmarrës në to.<sup>69</sup> Aktivistët e medias shprehen se institucionet publike e kanë ulur numrin e përgjigjeve të dhëna për kërkesat e të drejtës së informimit që vijnë nga gazetarët e mediave kritike. Gjohat dhe paditë kundër përfaqësuesve të medias kanë vazhduar.<sup>70</sup> Mekanizmat e intimidimit përfshijnë kërcënimet për ndekje penale fiskale dhe paketën anti-shpifje. Edhe *Indeksi i Lirisë së Shtypit në Botë nga Raportuesit pa Kufij* ka bërë një vlerësim të ngjashëm të situatës së medias në Shqipëri, duke e renditur atë në vendin e 82-të (nga 180 vende) në vitin 2015, pastaj në vendin e 75-të në vitin 2018, dhe në vendin e 84-të në 2020.<sup>71</sup>

Grafiku 3: Perceptimi i publikut për median përgjatë viteve 2015-2020



Burimi: Sondazh i opinionit publik *Besimi në Qeverisje* (IDM, UNDP) 2015; 2016; 2017; 2018; 2019; 2020.

67 Intervistë me një aktivist të shoqërisë civile.

68 Intervistë me një aktivist të shoqërisë civile.

69 Exit News (2020a), 'ShGE dënon përjashtimin e gazetares kritike nga diskutimi i kryeministrit Edi Rama me median' (ang.), 5 tetor (<https://exit.al/en/2020/10/05/135416/>).

70 Përgjatë viteve 2010-2020 ka pasur rreth 120 padi për shpifje kundrejt gazetarëve dhe medias. Rreth 37 prej tyre, ose 1/3 e të gjitha padive u bënë në 2018-2019. Shiko më shumë tek Nazifi, Ermal and Michael J. Orghia (2020), *Qeverisja e internetit në Shqipëri dhe roli i saj në lirinë e medias*, Tiranë: BIRN Albania, f. 22; f. 50

(<https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2020/09/Qeverisja-e-internetit.pdf>).

71 Reporterët pa Kufij, *Indeksi për lirinë e shtypit në botë* (ang.) (<https://rsf.org/en/ranking>).

Indeksi i *Raportuesve pa Kufij* dhe raportet e *Besimit në Qeverisje* përkojnë me të njëjtin përshkrim. Të dhënat nga vitet 2016, 2017 dhe 2018 tregojnë nivelin më të lartë të besimit të publikut në media, perceptimin më të ulët të ndërhyrjes politike në raport me vitet e tjera, dhe efikasitet të mirë të medias në të mbajturit e qeverisë së përgjegjshme. Pas 2018-ës, besimi pakësohet, ndikimi politik rritet, llogaridhënia e qeverisë ngec, ndërsa perceptimi i saktësisë së medias bie me 11%, çka sugjeron një rritje të propagandës. Viti 2017 sinjalizon fundin e valës së parë së intimidimit të medias dhe në të njëjtën kohë nisjen e valës së dytë, e cila ishte ende në veprim në 2020-tën.

Përmbledhurazi, politikat e qeverisë gjatë viteve 2015-2020, ligjërimi i saj publik dhe sulmet mbi median dhe gazetarinë e pavarur përgjatë kësaj periudhe kanë kufizuar të drejtën e shprehjes dhe kanë penguar pavarësinë e medias. Kësisoj, ato e kanë zvogëluar hapësirën qytetare, veçanërisht gjatë valës së dytë të intimidimit në 2017-2020. Në valën e dytë vërehet një ligjërim publik më i ashpër ndaj gazetarëve nga zyrtarët publikë, një rritje e numrit të padive, një mjedis ligjor i përkeqësuar dhe shtypje e zërave kritikë.

### **Angazhimi i qytetarëve në vendimmarrje dhe demokracia pjesëmarrëse – praktika të konsultimit publik**

Angazhimi qytetar është një tregues kyç i pasjes së një hapësire qytetare dhe demokracie të shëndetshme. Qytetarët marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes përmes konsultimeve publike, dëgjësave publike, kontakteve periodike me përfaqësuesit dhe zyrtarët publikë në sajë të, dhe me shoqërinë civile, si dhe me anë të protestave dhe peticioneve. Kjo pjesë fokusohet në procesin dhe politikat e konsultimit publik, në pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe lirinë e tubimit përgjatë viteve 2015-2020. Të dhënat tregojnë se pavarësisht mekanizmave të konsultimit publik që rregullojnë angazhimin qytetar, ky angazhim ka ardhur duke u pakësuar që prej viteve 2016-2017, tregues shqetësues për hapësirën qytetare.

Miratimi i ligjit 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” kishte si qëllim të forconte hapësirën qytetare mbi bazën e parimeve të demokracisë pjesëmarrëse dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të shtetit, shoqërisë civile dhe qytetarëve. Në 2014 zbatimi i këtij mekanizmi dukej premtues, bazuar në praktikat e konsultimit të projektligjeve që vijojnë. Ligji 115/2014 “Për ndarjen administrativo – territoriale të njësisë të qeverisë vendore në Republikën e Shqipërisë” ishte një nga projektligjet

e para që e zbatoi mekanizmin.<sup>72</sup> Një proces i konsultimit publik i përbërë nga dy cikle diskutimesh me ekspertë dhe përfaqësues të shoqërisë civile u mundësua me fonde ndërkombëtare nga projekti për Mbështetjen e Reformës Territoriale dhe Administrative, zbatuar nga PNUD Shqipëri. OShC-të u konsultuan edhe në procesin e reformës në drejtësi, në të gjitha fazat e tij që nga hartimi, konsultimi publik, miratimi dhe monitorimi.<sup>73</sup> Megjithatë, rasti i ligjit për arsimin e lartë tregoi se pavarësisht kalimit në procesin e konsultimit, projektligji nuk reflektoi kontributin e shoqërisë civile dhe u miratua i pandryshuar nga kuvendi në vitin 2015.

Një raport monitorues nga *ResPublica* mbi zbatimin e konsultimeve publike përgjatë viteve 2017-2018 argumenton se ligji vetë nuk është i mjaftueshëm për të garantuar një qasje pjesëmarrëse kuptimplotë, nëse qeveria nuk i përkushtohet procesit. Raporti konstaton<sup>74</sup> se qeveria shqiptare nuk është e interesuar ta zbatojë ligjin për shkak të praktikave në vijim. Nuk bëhen njoftime paraprake për konsultime. Kur këto të fundit reklamohen, praktikat nuk përmbushin detyrimet ligjore. Publiku shpreh pak interes, ndërsa pjesëmarrja e pak OShC-ve të përfshira vjen si pasojë e interesave të tyre të advokimit. Platforma online nuk është praktike dhe në 2/3-tat e të gjitha rasteve, autoritetet publike nuk japin përgjigje për rekomandimet e marra. Ministritë apo bashkitë publikojnë rrallë raporte vjetore të monitorimit të konsultimit publik. Raporti del në përfundimin se shumica e projektligjeve që miratohen nuk e zbatojnë procedurën, ndërsa ato që e bëjnë, e aplikojnë vetëm formalisht. Raportet e *Besimit në Qeverisje* (shiko tabelën 4) tregojnë se pjesëmarrja e qytetarëve në konsultimet publike ka rënë në mënyrë drastike që prej 2016.

---


72 PNUD Shqipëri (2015), 'Mbështetja për reformën administrative dhe territoriale: Për çfarë është programi?' (ang.) [https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/projects/democratic\\_governance/support-to-territorial-and-administrative-reform.html](https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/projects/democratic_governance/support-to-territorial-and-administrative-reform.html).

73 Dobrush, Andi (2016) 'Si po e reformon Shqipëria sistemin e saj të trazuar të drejtësisë?' (ang.), *Open Society Foundation Albania*, 12 shkurt (<https://www.osfa.al/publikime/how-albania-is-reforming-its-troubled-justice-system>).

74 Matlija, Dorian dhe Irena Dule (2019) *Konsultimi publik në Shqipëri 2017-2018*, f. 52-53.



Grafiku 4: Angazhimi i qytetarëve në hapësirën qytetare përgjatë viteve 2015-2020



Burimi: Sondazh i opinionit publik Besimi në Qeverisje (IDM, UNDP) 2015; 2016; 2017; 2018; 2019; 2020.

Të dhënat në tabelën 4 tregojnë se një shumicë e konsiderueshme e qytetarëve besojnë se ka pasur mungesë mundësish për pjesëmarrje në vendimmarrje. Megjithëse situata duket se po përmirësohet lehtë deri në vitin 2018, rritja e perceptimit për mungesën e mundësive në 2019 e ndali trendin në rënie në 2015-2017. Gjithashtu, angazhimi potencial vullnetar mbeti i lartë, çka sugjeron se njerëzit duan të angazhohen, por nuk janë të stimuluar për t'u mobilizuar, ose përballen me pengesa për t'u vullnetarizuar. Kjo e fundit është lidhur me mangësitë e vetë ligjit për vullnetarizimin.<sup>75</sup> Po ashtu, ulja e pjesëmarrjes në protesta ose peticione që prej 2016, tregon mungesë mobilizimi dhe përforcon perceptimin se mekanizmat e pjesëmarrjes në nivelet qendrore dhe vendore janë në rënie.

Ligjërimi publik i legjitimon protestat si mjetin e fundit demokratik që vihet në levizje kur një shoqëri i ka përdorur të gjitha mjetet e tjera demokratike. Bazuar në tabelën 4, mjetet e tjera demokratike janë mundësitë për pjesëmarrje në vendimmarrje dhe konsultimet publike. Perceptimi i publikut tregon se qytetarët nuk kanë qenë të kënaqur me zbatimin e këtyre mjeteve, veçanërisht gjatë viteve 2017-2020. Një shumicë e fortë prej 79% e të anketuarve besonin se u mungonin mundësitë për pjesëmarrje në vendimmarrje në 2016, edhe pse 62% e të anketuarve kishin marrë pjesë në konsultime publike. 57% e të anketuarve të të njëjtit kampion i vlerësuan dëgjesat publike si evente formale. Megjithatë, vetëm 22% e të anketuarve kishin marrë pjesë në protesta në vitin 2016. Viti 2018 tregon se të anketuarit ishin të

<sup>75</sup> Intervistë me një aktivist të shoqërisë civile. Për shembull, OShC-të që angazhojnë vullnetarë duhet t'i regjistrojnë ata në Tiranë në çdo aktivitet/ projekt ku ata marrin pjesë. Ky detyrim i demotivon OShC-ë për të përfshirë vullnetarë.

ndërgjegjshëm për ekzistencën e më shumë mundësive për pjesëmarrje në vendimmarrje. Megjithatë vetëm 8% e tyre kishin marrë pjesë në një konsultim publik dhe 67% besonin se dëgjuesat publike ishin formale. Edhe në këtë vit, vetëm 23% e të anketuarve kishin marrë pjesë në protesta. Të dhënat tregojnë se pjesëmarrja në protesta nuk është rritur dukshëm përkundër rënies së pjesëmarrjes në vendimmarrje. Kjo çështje kërkon një studim më të detajuar, por shifrat flasin tashmë me shqetësim për një qytetari më pak aktive, dhe si rezultat edhe për tkurrjen e hapësirës qytetare përgjatë viteve 2015-2020.

Legjislacioni aktual vendos pengesa për zbatimin e plotë të lirisë së tubimit në Shqipëri. Tubimet spontane nuk parashikohen nga ligji 8773/2001 “Për tubimet”. Ligji detyron njoftimin e Policisë së Shtetit për çdo organizim proteste, por në praktikë Policia zbaton Kodin Penal i cili kërkon marrjen e lejes së posaçme për organizimin e secilës protestës. Përgjatë viteve 2015-2020, Avokati i Popullit, shumë OShC dhe Raporte Progresi të Komisionit Evropian i kanë kërkuar vazhdimisht parlamentit dhe qeverisë ta ndryshojnë legjislacionin dhe ta legalizojnë të drejtën për tubime spontane, por këto të fundit nuk e kanë adresuar akoma çështjen. Qytetarët shqiptarë ende burgosen dhe dënohen për pjesëmarrje në protesta paqësore që mund të shndërrohen në të jashtëligjshme nëse policia vendos kësisoj.<sup>76</sup> Pavarësisht këtyre pengesave, numri i qytetarëve të burgosur dhe të dënuar për tubime të jashtëligjshme, ose për kundërshtim të forcave policore është rritur përgjatë viteve 2018-2020, çka shërben si një tjetër evidencë për tkurrjen e hapësirës qytetare.<sup>77</sup>

Si përfundim, ligji 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” ka qenë një mekanizëm përforcues në parim i hapësirës qytetare, por zbatimi i tij ka qenë formal dhe jo gjithëpërfshirës. Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike ka rënë në mënyrë drastike që prej 2017-ës, dhe po kështu, pjesëmarrja në protesta arriti pikën më të ulët në 2017. Ajo është rritur lehtë që nga atëherë, por vitet 2018-2020 shënojnë një numër të lartë të padive kundrejt qytetarëve të cilët kanë marrë pjesë në protesta të paligjshme. Pa marrë parasysh thirrjet, ligji 8773/2001 “Për tubimet” dhe Kodi Penal nuk u ndryshuan përgjatë viteve 2015-2020 dhe praktikisht, protestat spontane dhe të pamiratuara nuk lejohen. Përkeqësimi i zbatimit të mekanizmave të konsultimit publik dhe rënia e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje kanë

---

76 Për shembull, në 2018 studentët u mblodhën spontanisht në protestë para Ministrisë së Arsimit. Edhe pse ata e bllokuan trafikun për disa ditë, policia nuk ndërhyri. Në të njëjtin vit, protestuesit në zonën e Astirit u arrestuan dhe u proceduan për pjesëmarrje në tubime të paligjshme, bllokim trafiku, etj

77 Për një krahasim të mëtejshëm dhe analizë të detajuar referoju Avokatit të Popullit (2019), *Raport vjetor – mbi aktivitetin e institucionit të Avokatit të Popullit për 2018* (ang.), maj, f. 64-69

(<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Annual%20Report%202018.pdf>); dhe Avokati i Popullit (2020b), *Raport vjetor – aktiviteti i Institucionit të Avokatit të Popullit viti 2019* (ang.), f. 104-114 (<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Annual%20Report%202019.pdf>).

qenë të dukshme që prej 2017-ës e më tej, duke dhënë prova për tkurrjen e hapësirës qytetare veçanërisht gjatë viteve 2017-2020.

## **Përgjigja civile ndaj politikave qeveritare**

*Indeksi i Shoqërisë Civile për Shqipërinë* vuri në pah në 2010 se dimensionimi më i dobët i shoqërisë civile dhe “mangësitë më të mëdha (të saj) lidhen me shkallën e ulët të angazhimit qytetar dhe impaktit të kufizuar” të punës së sektorit në shoqëri.<sup>78</sup> Teksa pjesëmarrja në vendimmarrje dhe qytetaria aktive kanë ardhur në rënie që prej vitit 2017, rritja e organizimit civil prej 2016 ka sjellë një “rizgjim të shoqërisë civile.”<sup>79</sup> Organizimi civil ka ardhur si reagim ndaj politikave dhe reformave të ndryshme qeveritare gjatë pesë viteve të shkuara, si për shembull reforma në arsim, politika e menaxhimit të mbetjeve, politika energjitike, politika kulturore, politika infrastrukturore, etj. Ai arriti kulmin në 2018 kur studentët e universiteteve nga i gjithë vendi u bashkuan në protesta paqësore. Përgjatë viteve, OShC-të i kanë diversifikuar metodat dhe instrumentet e përdorura në kauzat qytetare duke vënë në punë propozimet për iniciativa ligjvënëse, peticionet, paditë gjyqësore dhe ndërkombëtarizimin e çështjeve në mbështetje të kauzave të tyre. Organizimi civil u gjallërua dhe fitoi qëndrueshmëri gjatë këtyre viteve, veçanërisht gjatë viteve 2018-2020. Gjithsesi përpjekjet e aktorëve civilë si OShC-të dhe media nuk u mbështetën masivisht nga qytetarët dhe rrallë i ndikuan politikat qeveritare. Pamjaftueshmëria e bashkimit të kauzave me njëra-tjetrën, shtrirjes së përpjekjeve në nivel kombëtar dhe ndikimit të politikëbërjes vjen prej tkurrjes së hapësirës qytetare.

Protestat e studentëve kundër reformës në arsimin e lartë qenë pika kulmore e vitit 2015.<sup>80</sup> Këto protesta morën mbulim kombëtar mediatik kur aktivistët e Lëvizjes për Universitetin gjuajtën me vezë makinën e kryeministrit, pas vizitës së tij në Universitetin e Tiranës. Akti i tyre tregoi pakënaqësi me ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”. Studentët e përfshirë në aksion u arrestuan dhe tetë

---

78 Vurmo, Gjergji et al (2010), *Indeksi i shoqërisë civile për Shqipërinë*, në kërkim të qytetarëve dhe impaktit (ang.), Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, f. 2 ([http://www.civicus.org/images/stories/csi/csi\\_phase2/csi%20albania%20acr\\_eng.pdf](http://www.civicus.org/images/stories/csi/csi_phase2/csi%20albania%20acr_eng.pdf)).

79 Lamallari, Besfort (2017), ‘Vendet në tranzicion 2017 – Shqipëria’ (ang.), *Freedom House* (<https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2017>).

80 Lamallari, Besfort (2016), ‘Vendet në tranzicion 2016 – Shqipëria’ (ang.), *Freedom House* (<https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2016>).

nga ta u dënuan me dy muaj burgim, i cili u zëvendësua me 60 orë pune vullnetare.<sup>81</sup> Çështja gjyqësore zgjati thuajse dy vjet.

Politika e debatuar qeveritare që prej dhjetë vitesh tanimë, për menaxhimin e importit të mbetjeve nxiti gjithashtu protesta në 2016. Ajo rigjallëroi lëvizjen mjedisore në Shqipëri e cila kishte kulmuar në nëntor 2013 me protestat kundër çmontimit të armëve kimike të Sirisë në Shqipëri. Në 2016 shumica në pushtet riktheu ligjin 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Ligji ishte konsideruar një shembull i kapjes së shtetit<sup>82</sup> dhe që pezulluar në 2013 në përgjigje të kundërshtimit masiv qytetar ndaj importit të mbetjeve. Ligji u amendua dhe u miratua nga qeveria në 2016. Kundërshtimi qytetar i udhëhequr nga Aleanca kundër Importit të Plehrave gjatë viteve 2010-2013 kundër ligjit 10463/2011 u gjallërua gjithashtu në 2016. Por këtë herë ishte shumë më pak i fuqishëm dhe më pak i mirëorganizuar. Ligji i amenduar dhe trashëgimia e pasur e rezistencës mjedisore civile i hapën rrugën Nismës Thurje që ngriti padi në Strukturën e Posaçme Antikorrupsion kundër procedurës së koncesionit të inceneratorit të Fierit, në 2020.<sup>83</sup> Pavarësisht rezultateve, protesta e vitit 2016 ishte një nga protestat e para të pas 2013 e cila ia doli të mobilizonte disa dhjetëra qytetarë, përveç OShC-ve që advokonin për mbrojtjen mjedisore.

Gjatë viteve 2016-2020, lëvizja mjedisore e mbështetur nga OShC-të u pasurua me aksione në nivel lokal të komuniteteve vendore, aktivistëve dhe artistëve që u bënë bashkë kundër ndërtimit të hidrocentraleve në parqe natyrore ose rrjedhat e lumenjve, si për shembull në Valbonë, Vjosë, Devoll dhe Mat. Komunitetet e prekura dhe aktivistët ndërthurën politikën energjitike me atë mjedisore, zhvillimin e qëndrueshëm dhe turizmin. Qytetarët e përfshirë në kauzë i kanë cilësuar projektet e hidrocentraleve si kërcënuese ndaj mjedisit, furnizimit me ujë dhe mikroekonomisë së komuniteteve të atjeshme.<sup>84</sup> Qytetarët dhe aktivistët thonë se shumica e projekteve nuk janë konsultuar me komunitetet vendore dhe këta të fundit kanë marrë informacion për projektet pasi ka filluar ndërtimi i hidrocentraleve.<sup>85</sup>

---

81 Panorama Online (2019), ‘Dënimi për studentët që qelluan Ramën me vezë. Apeli nuk u pranon ankimit. Ja arsyet’, 18 mars (<http://www.panorama.com.al/denimi-per-studentet-qe-qelluan-ramen-me-veze-apeli-nuk-u-pranon-ankimimin-ja-arsyet/>).

82 Kajsu, Blendi (2011) ‘Importi i mbetjeve si simptomë e kapjes’, *Panorma Online*, 2 nëntor (<http://www.panorama.com.al/importi-i-mbetjeve-si-simptome-e-kapjes/>).

83 Exit News (2020c), ‘Koncesionari i inceneratorit të mbetjeve të Fierit dërgohet në SPAK’ (ang.), 24 qershor (<https://exit.al/en/2020/06/24/fier-waste-incinerator-concessionary-reported-to-anti-corruption-prosecution/>).

84 BIRN Albania (2018) ‘Premiera e dokumentarit të BIRN Shqipërisë “Rrjedhë e lirë” (ang.)’, 11 qershor (<https://birn.eu.com/news-and-events/birn-albanias-documentary-free-flow-premiered/>).

85 Për më shumë informacion për këtë betejë shih Baxhaku, Elton (2018), *Free flow [Rrjedhë e lirë]*, Dokumentar, Tiranë: BIRN (<https://www.youtube.com/watch?v=RPnQWY8KsE8>).

Falë hulumtimit të thelluar shkencor, aktivizmit të vendosur, çështjeve gjyqësore të ndryshme dhe solidaritetit mes komuniteteve, aktivistëve, akademisë, artistëve, medias dhe donatorëve, pak nga këto projekte u pezulluan përkohësisht me vendim gjykate, si për shembull hidrocentrali i Poçemit në lumin Vjosa në 2017.<sup>86</sup> Bazuar në ankesën e OShC-së shqiptare *EcoAlbania* dhe partnerëve të saj ndërkombëtarë *Riverwatch* dhe *EuroNatur*, pjesë e iniciativës *Save the Blue Heart of Europe* [Shpëtoni zemrën blu të Evropës], në shtator 2020, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë hapi zyrtarisht një çështje kundër procedurave që ndjek Shqipëria për lidhjen e kontratave të hidrocentraleve.<sup>87</sup> Efektet e zgjidhjes së çështjes mbeten për t'u parë, por kauza mjedisore ia ka dalë tashmë të organizojë komunitetet vendore në bashkëveprim me OShC-të kombëtare dhe ndërkombëtare. Këto të fundit kanë ofruar ekspertizë ligjore profesionale<sup>88</sup> dhe kanë tërhequr vëmendjen e medias. Në këtë mënyrë është nxitur bashkëveprimi ndërkombëtar mes OShC-ve dhe ndër-profesionaliteti mes profesionistëve të ndryshëm. Për shembull, në vitet 2016-2017 muzikantët u përfshinë në një seri koncertesh-protesta të cilat kërkuan mbrojtjen e lumenjve dhe të natyrës.<sup>89</sup>

Prapëseprapë ndërtimi i hidrocentraleve ka ndaluar rrallëherë dhe dëmi në ekosistem është tashmë i pakthyeshëm. Hidrocentralet e Dragobisë dhe Çeremit në lumin Valbonë po ndërtohen, edhe pse gjenden në zona të mbrojtura të parkut kombëtar “Lugina e Valbonës” dhe pavarësisht se çështja është ende në proces për t'u gjykuar nga Gjykata e Lartë.<sup>90</sup> Edhe pse shumë komunitete vendore përballen me

---

86 Çështja e parë gjyqësore mjedisore në Shqipëri erdhi nga padia kundër hidrocentralit të Poçemit në lumin Vjosë. Vendimi i Gjykatës Administrative të Tiranës dhënë më 2 maj 2017 vuri në pah se Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis i projektit nuk ishte lëshuar sipas ligjit dhe nuk ishte bërë konsultimi i njëmendtë publik me komunitetin e prekur. Për rrjedhojë, diga e projektuar nuk duhet të ndërtohet. Lexo më shumë në: Environmental Justice Atlas (2019), ‘Diga e hidrocentralit të Poçemit u ndal’ (ang.), 18 gusht (<https://ejatlas.org/print/pocem-hydropower-dam-albania>).

87 Balkanrivers (2020) ‘Komuniteti i Energjisë forcon direktivat e politikave për projektet e vogla të hidrocentraleve dhe hap procedurë kundër Shqipërisë’ (ang.), 24 shtator (<https://www.balkanrivers.net/en/news/energy-community-tightens-policy-guidelines-small-hydropower-projects-and-opens-procedures>). Dhe Erebara, Gjergj (2020), ‘Shqipëria ‘shkeli direktivën e BE-së’ në dhënien e kontratës për hidrocentralin’ (ang.), *Balkan Insight*, 15 shtator (<https://balkaninsight.com/2020/09/15/albania-breached-eu-directive-in-awarding-hydropower-plant-contract/>).

88 WWF (2017) ‘Beteja ligjore e komuniteteve vendore për mbrojtjen e Parkut Kombëtar të Luginës së Valbonës nga zhvillimi i hidrocentraleve’ (ang.), 12 korrik (<https://wwf.panda.org/?304271/Legal-struggle-of-local-communities-to-protect-Valbona-Valley-National-Park-from-hydropower-development>).

89 Tirana Echo (2016) ‘Protesta muzikore për të mbrojtur Alpet Shqiptare dhe refuzuar importin e mbetjeve u hesht nga pronarët e mediave shqiptare’ (ang.), 1 nëntor (<http://www.tiranaecho.com/albania/musical-protest-to-protect-albanian-alps-and-refuse-waste-import-muted-blocked-by-albanian-media-owners/>).

90 Ndrevaaj, Entela (2020) ‘Punimet për HEC-et kthejnë ujin e kaltër të Valbonës në një rrjedhë të zbardhur nga inertet’, Citizens Channel, 25 shtator (<https://citizens-channel.com/2020/09/25/punimet-per-hec-et-kthejne-ujin-e-kalter-te-valbones-ne-nje-rrjedhe-te-zbardhur-nga-inertet/>).

të njëjtin kërcënim, betejat mjedisore nuk kanë arritur të bëhen çështje në nivel kombëtar dhe t'i mobilizojë qytetarët masivisht. Ato nuk kanë mundur të ndikojnë as ndryshimin e politikës qeveritare.<sup>91</sup>

Viti 2018 filloi me protestat e qytetarëve të Kukësit kundër tarifës për përdorimin e *Rrugës së Kombit*. Të filluara nga shoqatat e tregtarëve dhe të mbështetura nga qytetarët e thjeshtë, protestat përfunduan në përplasje me Policinë e Shtetit. Kjo ishte protesta e parë masive qytetare post 2013 që angazhoi qindra qytetarë të Kukësit dhe krahinës. Në kundërpërgjigje, Policia e Shtetit vendosi një regjim policor në Kukës. Shumë qytetarë u arrestuan në mënyrë të paligjshme dhe në shkelje të të drejtave civile sipas Avokatit të Popullit.<sup>92</sup> Shumë të tjerë u intimiduan me qëllim ndaljen e protestës. Për pasojë, taktika e mbylli protestën, por nga ana tjetër qeveria, u tërhoq nga plani i saj fillestar dhe gjeti një mekanizëm për ta ulur tarifën e përdorimit të rrugës për banorët e zonës, duke subvencionuar drejtpërdrejtë koncesionarin.<sup>93</sup>

Ndërkohë, kryeqyteti i Tiranës përjetoi tre protesta të gjata që u zhvilluan në të njëjtën kohë gjatë vitit 2018: qëndresa kundër prishjes së Teatrit Kombëtar, protesta e banorëve të Astirit kundër projektit të ndërtimit të Unazës së Re dhe protestat e studentëve për gjendjen e sistemit të arsimit të lartë. Të treja grupet kërkuan zhvillim të qëndrueshëm urban në tre dimensione të ndryshme: kulturor, infrastrukturor dhe shoqëror. Prapë, protestat nuk arritën t'i drejtojnë apo përbashkojnë përpjekjet nën kauzën e tyre të përbashkët, pavarësisht organizimit të vlerësuar, origjinalitetit dhe aktivizmit që shpërfaqën.<sup>94</sup>

Secila protestë solli risi në angazhimin qytetar në Shqipëri. Protestat e studentëve dhanë një lëksion për lirinë e shprehjes përmes parullave krijuese dhe kritike kundër vjedhjes, largimit të trurit, plagjiaturës së profesorëve dhe ngacmimit seksual nga ta, etj. Ato sintetizuan gjendjen e rënduar të universitetit, politikat arsimore dhe menaxhimin e burimeve njerëzore në tërësi. Studentët shfaqën guxim përkundër intimidimeve teksa u përballën me kryeministrin gjatë konsultimeve publike që vijuan

---

91 Në mes të protestave, qeveria ka vazhduar të miratojë vendime për ndërtimin e hidrocentraleve, si ato në lumin Cem në vitet 2018 dhe 2019. Më shumë në EcoAlbania (2020), 'Lumi Cem – i kërcënuar nga ndërtimi i hidrocentraleve', 20 qershor

(<https://www.ecoalbania.org/sq/2020/06/20/lumi-cem-i-kercenuar-nga-ndertimi-i-hidrocentraleve/>).

92 Exit News (2018a), 'Protesta kundër tarifave në Rrugën e Kombit – Çfarë dimë deri më tani?' 3 prill (<https://exit.al/protesta-kunder-tarifave-ne-rrugen-e-kombit-çfare-dime-deri-me-tani/>).

93 Exit News (2018c) 'Qeveria plaçkit buxhetin e shtetit për koncesionarin e Rrugës së Kombit' (ang.), 6 shtator (<https://exit.al/en/2018/09/06/government-plunders-state-budget-for-rruga-e-kombit-concession-holder/>).

94 Për një analizë të detajshme shih Azizi, Orgest (2020), 'Për një fenomenologji politike të protestës', *Peizazhe të fjalës* 5 dhjetor (<https://peizazhe.com/2020/12/05/per-nje-fenomenologji-politike-te-protestes/>).

pas protestave. Edhe pse taktikat shtypëse ia dolën t'i shpërndajnë protestat, aksioni studentor e detyroi qeverinë të ndryshonte kabinetin qeveritar dhe e solli universitetin dhe angazhimin qytetar në vëmendjen e shoqërisë së gjerë shqiptare. Në anën tjetër, protestat e organizuara nga banorët e zonës së Astirit në Tiranë ia arritën të pezullojnë përkohësisht procedurën e ofertimit për ndërtimin e rrugës së Unazës së Madhe, e cila pati parregullsi.<sup>95</sup> Shtëpitë e tyre u prishën në mars 2020 dhe ata vazhdojnë të përballen me akuzat në lidhje me qëndresën e tyre dhe organizimin e protestave spontane, e për pasojë të paligjshme.

Në mbyllje, qëndresa kundër prishjes së Teatrit Kombëtar gjatë viteve 2018-2020 solli në vëmendjen e publikut rëndësinë e kulturës, monumenteve të kulturës dhe nevojës për të ruajtur trashëgiminë kombëtare të Shqipërisë. Gjatë qëndresës, Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit Kombëtar organizoi veprimtari ditore si takime publike dhe shfaqje publike. Artistët zaptuan ndërtesën dhe e bënë teatrin një hapësirë të përbashkët qytetarë. Në bashkëpunim me Fondacionin Gjirokastra, ata ia dolën ta ndërkombëtarizojnë kauzën e mbrojtjes së kompleksit të ndërtesave. Organizata Europa Nostra e renditi kompleksin e Teatrit Kombëtar në krye të listës së shtatë ndërtesave të trashëgimisë kulturore më të rrezikuara në Evropë<sup>96</sup> dhe u angazhua në ngritjen e fondeve për restaurimin e saj. Pas prishjes brutale të kompleksit në maj 2020, një listë studiuesish, artistësh dhe qytetarësh nënshkruan një letër të hapur drejtuar komunitetit ndërkombëtar dhe kërkuan ndaljen e përdorimit të artit për të legjitimuar politikën e kryeministrit Rama.<sup>97</sup>

Në 2019, gazetarët gjithashtu protestuan kundër miratimit të paketës anti-shpifje. Ata morën mbështetje ndërkombëtare nga Qendra Evropiane për Shtypin dhe Lirinë e Medias, Federata Evropiane e Gazetarëve, Instituti Ndërkombëtar i Shtypit<sup>98</sup> dhe nga Këshilli i Evropës dhe Komisionerja për të Drejtat e Njeriut.<sup>99</sup> Edhe pse advokacia nuk e parandaloi miratimin e paketës nga kuvendi, falë saj, Komisioni Evropian rekomandoi amendimin e ligjeve, në përputhje me lirinë e shprehjes.

---

95 Taylor, Alice Elizabeth (2019b) 'Pesëmbëdhjetë arrestime pas protestës së qytetarëve kundër prishjes së shtëpive të tyre' (ang.), Exit News 14 tetor (<https://exit.al/en/2019/10/14/fifteen-arrests-after-citizens-protest-against-demolishment-of-their-homes/>).

96 Europa Nostra (2020), 'Shpallen shtatë sitet e trashëgimisë kulturore më të rrezikuara të Evropës në 2020' (ang.), 24 mars (<https://www.europanostra.org/europe-7-most-endangered-heritage-sites-2020-announced/>).

97 Di Liscia, Valentina (2020), 'Letra e hapur dënon "artshplarjen" e politikës së kryeministrit shqiptar' (ang.), Hyperallergic 19 maj, (<https://hyperallergic.com/565114/open-letter-condemns-artwashing-albania/>).

98 Bazuar në ibid.

99 Komisioneri për të Drejtat e Njeriut (2019) 'Komisioneri e nxit Kuvendin e Shqipërisë të rishikojë projektligjin që kufizon lirinë e shprehjes' (ang.), Strasburg: Këshilli i Evropës 17 dhjetor (<https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/commissioner-urges-albania-s-parliament-to-review-bills-which-restrict-freedom-of-expression>).

Pas shumë vitesh përpjekjesh, lëvizja punëtore shfaq shenja të vetëorganizimit në 2019.<sup>100</sup> OShC-të i kanë dhënë mbështetje punëtorëve të ngrenë organizata kolektive, si rezultat i të cilave u formuan sindikata të reja punëtorësh, si për shembull Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës. Kompania private e cila e menaxhon minierën pushoi nga puna kryetarin dhe minatorët e tjerë, për hir të vetë aktit të themelimit të sindikatës.<sup>101</sup> Ndërkohë, punëtorët e rafinerisë së Ballshit zhvilluan një sërë protestash prej vitit 2018, që u pasuan nga greva e urisë 44 ditore në 2020, e cila kërkonte pagesën e rrogave të prapambetura. Vetëm pasi një nga punëtorët tentoi të vetëvritej në nëntor 2020, protestuesit dhe qeveria pranuan të negociojnë dhe gjetën një zgjidhje.<sup>102</sup>

Që prej vitit 2019 shoqëria civile është angazhuar në dy iniciativa për të ndryshuar sistemin zgjedhor në vend. E para që një peticion i nënshkruar nga më shumë se 50,000 qytetarë dhe u dorëzua në Kuvendin e Shqipërisë nga përfaqësuesit e Nismës Thurje, mbështetur nga dy deputetë të kuvendit. Tjetra që një kërkesë procedurale e nisur nga një grup qytetarësh që synonte organizimin e një referendumi për sistemin zgjedhor, që u refuzua nga Komisioni Qëndror Zgjedhor. Kjo përbën një rast të përsëritur pasi qytetarëve shqiptarë u është refuzuar disa herë e drejta për të shprehur vullnetin e tyre në referendum, për shkak të mungesës së ligjit për referendumet.

Për ta adresuar këtë boshllëk legjislativ, organizata joqeveritare INFOÇIP ndërmori nismën që të hartonte një projektligj për referendumet i cili rrit demokracinë pjesëmarrëse. Në 2016, ekspertët ligjorë të angazhuar në hartimin e tij organizuan konsultime me përfaqësues të tjerë të shoqërisë civile. Versioni i riparë u pranua për procedurë parlamentare në kuvend në shtator 2020 dhe u mbështet nga një deputet.<sup>103</sup> Nëse miratohet, ligji për referendumet dhe aktet e mundshme nënligjore për zbatimin e tij do të mundësonin bazën ligjore për lehtësimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe forcimin e hapësirës qytetare.

Në përmbyllje, kjo pjesë e dokumentit prezantoi disa raste të betejave të ndryshme civile që u organizuan në Shqipëri mes viteve 2015-2020. Çka i bashkon këto

---

100 Xhafa, Edlira (2020), 'Lindja e vështirë e një lëvizjeje punëtore të pavarur në Shqipëri' (ang.), 14 janar (<https://smbb.substack.com/p/the-difficult-birth-of-an-independent>).

101 Curri, Sami (2020) 'Vendimi i Komisionerit: Albchrome i shkarkoi minatorët për shkak të angazhimit sindikal', *Reporter.al* 3 nëntor (<https://www.reporter.al/vendimi-i-komisionerit-albchrome-i-shkarkoi-minatorët-per-shkak-te-angazhimit-sindikal/>).

102 Exit News (2020d), 'Pagat e punëtorëve të rafinerisë së naftës së Ballshit do të dalin nga fondi i COVID-19' (ang.), 19 nëntor (<https://exit.al/en/2020/11/19/ballsh-oil-workers-salary-to-come-from-covid-19-fund/>).

103 INFOCIP (2020), 'Projektligji "Për referendumet" hyn në proces legjislativ. Nisma e INFOÇIP, e konsultuar me shoqërinë civile një hap më pranë realizimit përfundimtar', shtator (<https://www.infocip.org/al/?p=13560>).



përpyqje është se shumica kanë qenë të palidhura mes tyre, përsërisin njëra-tjetrën dhe nuk ia dalin të vendosin precedentë. Shumica e projekteve nuk kanë qenë konsultuar me publikun dhe reagimi qytetar erdhi kur pjesa më e madhe e dëmit ishte bërë tashmë. Për pasojë, betejat qytetare shënuan fitore të përkohshme, por dështuan të frymëzojnë pjesëmarrjen qytetare në shkallë të gjerë dhe të ndryshojnë politikat e qeverisë. Për shembull, prishja e Teatrit Kombëtar në 17 maj 2020 u pasua menjëherë nga një prishje tjetër simbolike: Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit i restauruar nuk u përrua nga artistët, por nga një emision televiziv me personazhe kryesore kryeministrin dhe analistët.<sup>104</sup> Gjithsesi, bashkëveprimi mes komuniteteve, qytetarëve, grupeve informale dhe OShC-ve është përmirësuar gjatë viteve 2015-2020, veçanërisht që prej vitit 2016, për shkak të përpjekjeve gjithëpërfshirëse të çështjes mjedisore. Publiku i gjerë po vetëdijësohet më shumë për punën e ndërmarrë nga shoqëria civile dhe po e rrit besimin në sistem. Në të njëjtën kohë, beteja qytetare ka përfituar kapacitete organizative gjatë viteve 2016-2020. Repertori i aksionit qytetar është rritur gjithashtu. Përveç mjeteve tradicionale të protestës si greva, greva e urisë dhe peticionet, janë përfshirë mjete të reja si për shembull nismat ligjvënëse, çështjet ligjore dhe solidariteti e bashkëveprimi ndërkombëtar ndërmjet OShC-ve dhe institucioneve ndërkombëtare.

## **Ndikimi i kufizimeve të Covid-19 mbi hapësirën qytetare**

Masat kundër pandemisë COVID-19 të ndërmarra nga qeveria gjatë vitit 2020 e tkurrën më tej hapësirën qytetare në Shqipëri. Në mars 2020, qeveria shqiptare njoftoi Këshillin e Evropës për kufizimet e të drejtave dhe lirive të njeriut, në përgjigje ndaj pandemisë së COVID-19 dhe në përputhje me aktin normativ nr. 3/2020.<sup>105</sup> Për të forcuar zbatimin e kufizimeve, ekzekutivi nisi amendimin e Kodit Penal në prill 2020. Qëllimi i amendimit që normatizimi i mëtejshëm i gjendjes së jashtëzakonshme dhe gjendjes së emergjencës në raste të fatkeqësisë natyrore, në të cilën u përfshinë dhe epidemitë. Projektligji përfshiu gjopa të larta dhe dënime me burg deri në tri vite për ata të cilët do të shkelnin dispozitat ligjore të karantinës. Amendimet e Kodit Penal u miratuan nga kuvendi dhe u dekretuan nga presidenti. Organizata të ndryshme të shoqërisë civile i kërkuan qeverisë të përmbahej nga amendimi i kodit. Në këndvështrimin e tyre, këto amendime nuk u bënë sipas procedurës parlamentare, ishin joproporcionale dhe “nuk respekto[nin] parimin e humanizmit i

---

104 Dritare (2020), “Shija e tmerrshme e përrimit të TKOB”, 21 maj (<https://dritare.net/ngjarjet-e-dites/shija-e-tmerrshme-e-perurimit-te-tob-191>).

105 Këshilli i Ministrave (2020) ‘Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19’, Akti Normativ nr. 3, datë 15.3.2020, Fletore Zyrtare (37) 15 mars (<https://qbz.gov.al/eli/akt-normativ/2020/03/15/3>).

parashikuar në Kodin Penal dhe cëno[nin] të drejtat dhe liritë e shtetasve”.<sup>106</sup> Amendimi i Kodit Penal legalizoi çdo akt nënligjor të nxjerrë nga autoritetet publike në lidhje me situatë e krijuar nga pandemia COVID-19 dhe kriminalizoi shkeljen e protokolleve të sëmundjes. Për pasojë qeveria ndaloi të drejtën e tubimit gjatë gjendjes së emergjencës sipas urdhrin të Ministres së Shëndetësisë nr. 132, datë 8.3.2020 dhe kufizoi grumbullimet me pjesëmarrje deri në dhjetë persona, sipas urdhrin të Ministres së Shëndetësisë nr. 633, datë 17.11.2020.<sup>107</sup>

Në maj 2020, dhjetë aktivistë të shoqërisë civile u ndaluan nga Policia e Shtetit gjatë pjesëmarrjes së tyre në një protestë të njoftuar publikisht, edhe pse ishin në ambient të hapur dhe po respektonin distancimin social. Ata protestuan kundër prishjes së Teatrit Kombëtar dhe kundër shtyrjes së kohëzgjatjes së izolimit të shkaktuar nga COVID-19. Ndërhyrja e policisë u argumentua si nevojë për të vendosur masat e distancimit gjatë pandemisë, dhe për të ndjekur penalisht shkelësit e tyre. Por imazhet e mediave tregojnë se në zonë pati më shumë policë të pranishëm sesa vetë protestues.<sup>108</sup> Në të njëjtën ditë media raportoi se qytetarë të tjerë ishin mbledhur në bregdet, të pashqetësuar nga policia.<sup>109</sup> Në 17 maj 2020 Policia e Shtetit ndërhyri në prishjen e Teatrit Kombëtar. Ajo ndaloi 64 qytetarë gjatë aksionit<sup>110</sup> dhe akuzoi nëntë të tjerë për protestë të paligjshme, pa leje nga policia dhe në shkelje të akteve ligjore të cilat ndalonin tubimet gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore.<sup>111</sup> Sipas raportit të Avokatit të Popullit për këtë ngjarje, Policia e Shtetit shkeli të drejtat e qytetarëve, përdori dhunë në disproporcionalitet dhe u bë një përhapëse potenciale e COVID-19.<sup>112</sup>

---

106 Komiteti Shqiptar i Helsinkit (2020), “Deklaratë e përbashkët për median”, 11 prill (<https://ahc.org.al/deklarate-e-perbashket-per-median/>).

107 Për më shumë detaje lexoni Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 132, datë 8.3.2020 “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura” në <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/03/08/132/9f294e1a-c737-4fc6-a46a-eea2a825c3eb> dhe Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 633, datë 17.11.2020 “Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura” në <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/11/17/633/5c8ca1e2-0838-4488-9f0b-2ecfbc756f45>

108 Avokati i Popullit (2020a), ‘Avokati i Popullit reagon mbi përplasjet në sheshin “Skënderbej”, 9 maj (<https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/news/this-article-is-available-only-in-albanian-479/>)

109 BalkanWeb (2020), ‘VIP-at shqiptarë nuk pyesin për koronavirusin’, 9 maj (<https://www.balkanweb.com/vip-at-shqiptare-nuk-pyesin-per-koronavirusin-me-bikini-ne-plazhet-e-jugut-e-duke-festuar-prane-zjarrit-gjate-darkave-ne-borsh/>).

110 Policia e Shtetit (2020a) ‘Raporti i ngjarjeve për 72 orët e fundit, Policia e Shtetit’, 18 maj (<https://www.asp.gov.al/raporti-i-ngjarjeve-per-72-oret-e-fundit-policia-e-shtetit-34/>).

111 Policia e Shtetit (2020b) ‘Tiranë – Organizuan protestë të paligjshme, procedohen penalisht 9 persona’, 19 maj (<https://www.asp.gov.al/tirane-organizuan-proteste-te-paligjshme-procedohen-penalisht-9-persona/>).

112 Avokati i Popullit (2020c), *Rekomandime mbi veprimet/ mosveprimet e kundërligjshme të strukturave të Policisë së Shtetit gjatë dhe pas prishjes së godinës së Teatrit Kombëtar*, 17 nëntor, f. 6; 8; 19; 31-32

Avokati i Popullit vërejtë se autoritetet publike patën organizuar grumbullime, takime, konsultime publike dhe koncerte në ambiente të hapura gjatë pandemisë, ndërkohë që protestat e organizuara nga qytetarët nuk u lejuan nga policia.<sup>113</sup> Këto standarde të dyfishta tregojnë se problemi qëndronte tek qëllimi i grumbullimeve, më shumë sesa tek numri i pjesëmarrësve të përfshirë në to. OShC të ndryshme kërkuan rishikimin e akteve ligjore që ndalonin lirinë e tubimit dhe kriminalizonin të drejtën e protestës në pandemi,<sup>114</sup> por asnjë nga kërkesat e tyre dhe as rekomandimet e Avokatit të Popullit nuk u morën në konsideratë nga qeveria. Ndërsa zhvillimet e lidhura me kufizimet e hapësirës qytetare gjatë vitit 2020 dhe pandemisë kanë nevojë për shqyrtim më vete, praktikat arbitrare të Policisë së Shtetit ngrenë alarmin për rrezikun e konsolidimit të shtetit policor i cili vepron në një gjendje të jashtëzakonshme të përhershme në Shqipëri.

---

(<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20Teatri%20Kombetar%20n%20ntor%202020.pdf>).

113 Avokati i Popullit (2020ç), 'Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme për respektimin e lirisë kushtetuese të tubimit edhe gjatë gjendjes së jashtëzakonshme', f. 7 (<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%20C3%ABr%20marrjen%20e%20masave%20t%20C3%AB%20nevojshme%20p%20C3%ABr%20respektimin%20e%20liris%20C3%AB%20kushtetuese%20t%20C3%AB%20tubimit%20edhe%20gjat%20C3%AB%20gjendjes%20s%20C3%AB%20jasht%20C3%ABzakonshme.%20.pdf>).

114 Qëndresa Qytetare (2020), '35 organizata dhe sindikata letër të hapur institucioneve për të drejtën e protestës në kohë pandemie', 19 nëntor (<https://qq.com.al/index.php/2020/11/19/35-organizata-dhe-sindikata-leter-te-hapur-institucioneve-per-te-drejte-e-protestes-ne-kohe-pandemie-mungesa-e-protestes-vret-demokracine-e-per-pasojte-jeten-e-qytetareve-te-cilet-nese-qeverisen-nuk/>).

Ky dokument shqyrtoi zhvillimin e hapësirës qytetare në Shqipëri gjatë viteve 2015-2020. Ai u ngrit mbi supozimin se një hapësirë e fuqishme qytetare kontribuon në konsolidimin e demokracisë dhe nëse progresi në këtë drejtim ndalohej, tkurrja e hapësirës qytetare bëhet një simptomë e zbrapsjes demokratike. Në fokus të analizës qenë politikat qeveritare dhe praktikatat të cilat kanë ndikuar hapësirën qytetare dhe kontribuesit e saj: OShC-të, mediat dhe qytetarët. Trendi i zhvillimit të hapësirës qytetare u mat përmes progresit të arritur për konsolidimin e lirive të njeriut dhe të drejtave civile, me fokus në zbatimin e ligjeve dhe strategjive në këtë drejtim. Pjesëmarrja e qytetarëve në hapësirën publike dhe civile u vlerësua përmes pjesëmarrjes në konsultimet publike, mundësitë për pjesëmarrje në vendimmarrje dhe lirinë e tubimit. Qëndrueshmëria dhe përshtatshmëria e shoqërisë civile u vlerësua sipas politikave për lirinë e organizimit dhe mjedisin mundësues të shoqërisë civile. Ndërsa pavarësia e medias u analizua përmes politikave dhe praktikave për lirinë e shprehjes. Bazuar në analizë, dolën përfundimet e mëposhtme:

1. Tkurrja e hapësirës qytetare ka qenë trend në zhvillim në Shqipëri gjatë viteve 2015-2020 dhe është një simptomë e zbrapsjes demokratike. Ajo është manifestuar në hapat e vazhdueshme prapa të lidhura me lirinë e shprehjes dhe lirinë e tubimit veçanërisht gjatë viteve 2018-2020; në kontrollin e shtuar mbi shoqërinë civile që prej vitit 2019 dhe rënies drastike të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, konsultime publike dhe protesta që prej viteve 2016-2017. Politikatat dhe masat e lidhura me menaxhimin e pandemisë COVID-19 veçse thelluan trendin ekzistues.
2. Ekzekutivi shqiptar dhe kuvendi kanë qenë efektivë në nxjerrjen e legjislacionit gjatë viteve 2015-2020. Një sërë ligjesh dhe amendamentesh janë miratuar nga kuvendi me synim forcimin e hapësirës qytetare. Veçse zbatimi i tyre përmes strategjive, planeve të veprimit, udhërrëfyesve, etj. ka qenë problematik dhe i ngadaltë. Mbiprodhimi i ligjeve që nuk mbështeten nga aktet e nevojshme ekzekutive ligjoro-administrative dhe nga burime të mjaftueshme njerëzore dhe ekonomike, ka sjellë një zbatim të dobët të legjislacionit. Në të njëjtën kohë, mbiprodhimi i ligjeve të cilat nuk përputhen apo harmonizohen me njëra-tjetrën ose me aktet përkatëse ekzekutive ligjoro-administrative ka pasur efekte negative, që kanë ndikuar zbatimin e sundimit të ligjit në vete dhe kanë penguar fuqizimin e hapësirës qytetare.

3. Qeveria nuk ka aplikuar një proces konsultimi publik të njëmendtë dhe të vlefshëm. OShC-të dhe qytetarët konfirmojnë se pjesëmarrja e tyre në proces është kufizuar dhe ka ardhur në rënie që prej vitit 2016. Anashkalimi i procesit konsultues ka rritur nevojën për amendime ligjore, gjë e cila ka rritur mbiprodhimin e ligjeve dhe për pasojë, ka vonuar zbatimin e tyre.
4. Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile e ka humbur mundësinë për të rritur bashkëveprimin mes OShC-ve dhe qeverisë. Dokumenti strategjik i kësaj të fundit, Udhërrëfytyesi për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile në Shqipëri 2015-2019 nuk ia doli të zbatojë rreth 80% të aktiviteteve të planifikuara. Në vend që të lehtësonte procedurat, veprimet dhe praktikat e qeverisë kanë rezultuar në kontroll të shtuar për OShC-të, duke dobësuar funksionimin e tyre e për pasojë, duke kontribuar në tkurrjen e hapësirës qytetare në vend. Udhërrëfytyesi 2019-2023 jep pak shpresë për adresimin e shqetësimeve të OShC-ve.
5. Gjatë viteve 2015-2020, financimi publik për OShC-të ka mbetur i kufizuar dhe jo transparent. Për shkak të krizës së shkaktuar nga COVID-19, në 2020 qeveria rialokoi fondet e projekteve të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, duke shkaktuar një ulje të ndjeshme prej më shumë se 40% të financimit të OShC-ve, krahasuar me vitin e kaluar. Kjo rënie e solli buxhetin e sektorit në pikën e tij më të ulët në pesë vitet e fundit. Kjo e dobësoi më tutje rolin e Agjencisë në fuqizimin e sektorit civil në Shqipëri.
6. Të dhënat tregojnë se OShC-të kanë shënuar progres gjatë viteve 2015-2020. Ama, evoluimi i tyre duket se lidhet më shumë me donatorët dhe përpjekjet autonome të OShC-ve, sesa me kuadrin ligjor dhe të politikave të cilat mbeten pengesa për to.
7. Sektori i medias është përballur me gjuhë të ashpër kundër gazetarëve, intimidime, sulme, censurë dhe vetëcensurë gjatë viteve 2015-2020. Paketa anti-shpifje ka qenë kulmi i një serie në rritje të 'shqetësimeve për censurën dhe vetëcensurën e shtuar, dhe hap pas për lirinë e shprehjes në vend', veçanërisht në 2019 dhe 2020. Ajo evidenton tkurrjen e hapësirës qytetare si pasojë e politikave dhe praktikave qeveritare.
8. Që prej vitit 2016, Shqipëria ka dëshmuar një 'rizgjim të shoqërisë civile' dhe ka përmirësuar organizimin qytetar që prej 2013. Repertori i aksionit qytetar ka përfshirë instrumente të reja si për shembull nisma ligjore, procese gjyqësore dhe ndërkombëtarizimin e kauzave qytetare, bashkë me mjetet e tjera tradicionale të tilla si protestat, petitionet dhe grevat e urisë. Fakti se deputetët kanë mbështetur publikisht nisma ligjore veçanërisht gjatë viteve 2019-2020 ka

- qenë një zhvillim pozitiv. Por ama shumica e këtyre përpjekjeve qytetare nuk lidhen me njëra-tjetrën dhe rrallë ia kanë dalë të ndikojnë politika qeveritare.
9. Përmirësimi i organizimit civil nuk e ka rritur angazhimin qytetar në vendimmarrje. Kjo e fundit ka rënë në mënyrë drastike që prej vitit 2016 dhe mbetet një nga manifestimet më të dukshme të tkurrjes së hapësirës qytetare në vend.
  10. Ligjet vendosin pengesa për zbatimin e plotë të lirisë së tubimit në Shqipëri. Tubimet spontane nuk përfshihen në ligjin për tubimet. Për shkak të përplasjes së legjislacionit me Kodin Penal, detyrimi i ‘njoftimit’ formal për organizim proteste, praktikohet në vazhdimësi nga Policia e Shtetit si detyrim për ‘marrje lejeje’. Pavarësisht rekomandimeve të përsëritura nga institucionet shtetërore dhe ndërkombëtare, problemi nuk është adresuar dhe mbetet baza e një serie cenimesh të së drejtës së tubimit. Këto të fundit ndodhën veçanërisht gjatë viteve 2018-2020 kur u rrit ndjeshëm numri i protestave të paligjshme dhe numri i qytetarëve të ndaluar prej pjesëmarrjes në to.
  11. Pas amendimit të Kodit Penal në nisje të pandemisë COVID-19, qeveria zbatoi vendosjen e gjobave dhe dënimeve më të larta me burg për personat që shkelnin dispozitat ligjore gjatë gjendjes së jashtëzakonshme ose fatkeqësisë natyrore. Shumë organizata të shoqërisë civile i konsideruan dënimet joproporcionale, në kundërshtim me parimin e humanizmit të vendosur nga Kodi Penal dhe në shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut. Zbatimi i tyre vendos alarmin për tkurrjen e hapësirës qytetare në Shqipëri, por edhe për rrezikun e konsolidimit të shtetit policor që vepron në një gjendje të përhershme të jashtëzakonshme.

Për të filluar adresimin e problemit, vijojnë si më poshtë rekomandimet e mbështetura në literaturë dhe në intervistat me aktivistë të shoqërisë civile:

- Kuvendi duhet të ndryshojë paketën anti-shpifje në përputhje me rekomandimin e Komisionit të Venecias dhe qeveria qendrore duhet të mbështesë zhvillimin e trupave vetërregulluese brenda medias.
- Kuvendi duhet të amendojë ligjin 119/2015 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile” për të garantuar pavarësinë e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile nga ndërhyrja e shtetit. Kuvendi duhet të shqyrtojë amendimin e një sërë ligjesh të cilat e kanë penguar mjedisin mundësues të shoqërisë civile gjatë viteve 2015-2020, si për shembull ligji 45/2016 “Për vullnetarizmin”, ligji 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale në

Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

- Kuvendi duhet të avancojë në komisionet e përhershme procedimin normal të projektligjit “Për referendimet” i nisur nga organizatat e shoqërisë civile. Ligji do të legalizonte të drejtën e referendimit për qytetarët shqiptarë dhe do të shtonte një mjet për pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje, duke forcuar hapësirën qytetare.
- Kuvendi duhet të amendojë ligjin 144/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” bazuar në një proces konsultimi të njëmendtë, të gjerë dhe gjithëpërfshirës me OShC-të, ekspertë ligjorë dhe hulumtues për të përcaktuar të gjitha nevojat dhe çështjet për t’u zgjidhur dhe adresuar.
- Kuvendi duhet të amendojë ligjin 8773/2001 “Për tubimet” për të garantuar zbatimin e lirisë së tubimit në mënyrë paqësore. Nevoja për të legalizuar të drejtën për tubim spontan dhe për të diferencuar mes detyrimit për ‘njoftim’ dhe atij për ‘leje’ duhet marrë seriozisht pas rekomandimeve të përsëritura të aktorëve të ndryshëm brenda shtetit dhe atyreve ndërkombëtarë. Policia e Shtetit duhet ta digjitalizojë procesin e njoftimit përmes portalit virtual e-Albania.
- Qeveria qendrore dhe vendore duhet të angazhohen në konsultime sistematike me shoqërinë civile, grupet informale dhe komunitetet vendore për të avancuar reformat dhe për të mundësuar një dialog politikash të vazhdueshëm. Praktikuesit nga zyrat publike duhet të diversifikojnë metodologjinë e konsultimit publik duke përfshirë një sërë metodash të tjera të tilla si dialogu me qytetarët, kuvendi i qytetarëve, buxhetimi me pjesëmarrje, etj. në përputhje me temën dhe problemin e dhënë.
- Shërbyesit civilë të institucioneve publike duhet të formojë grupe konsultuese dhe të organizojnë takime periodike të specializuara me përfaqësues nga shoqëria civile dhe ekspertë të pavarur. Shërbimi civil dhe shoqëria civile ndajnë qëllime të njëjta dhe janë të dyja pjesë të sferës sociale. Rritja e bashkëpunimit të tyre mund të fuqizojë përpjekjet, të përmirësojë shërbimin publik dhe të forcojë hapësirën qytetare.
- Qeveria qendrore duhet të angazhohet seriozisht në zbatimin e Udhërrëfyesit 2019-2023 për mjedisin mundësues të shoqërisë civile. Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile duhet të rrisë buxhetin dhe transparencën për ndarjen e granteve të saj publike.
- Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile duhet të kalojë përmes një procesi reformues përfshirës dhe të konsultuar, që ka si synim forcimin e rolit dhe kontributit të saj në përparimin e sektorit të shoqërisë civile në Shqipëri. Ajo

duhet të rrisë transparencën dhe përfshirjen e të gjithë aktorëve që janë pjesë e përzgjedhjes së organeve të saj. AMShC duhet të angazhohet në konsultime publike me OShC-të për përzgjedhjen e prioriteteve dhe fushave që financohen nga buxheti i shtetit. Ajo duhet të rrisë transparencën e procesit të vlerësimit të aplikimeve në thirrjet për projekt-propozime dhe parimet që udhëheqin shpërndarjen e financimit publik tek përfituesit: organizatat e shoqërisë civile fituese të thirrjeve për propozime.

- Qeverisja qendrore duhet të investojë në specializimin e burimeve njerëzore dhe në infrastrukturën e mbledhjes së të dhënave dhe transparencës. Vlerësuesit dhe analizuesit e të dhënave në të gjitha institucionet shtetërore duhet të monitorojnë, të masin dhe vlerësojnë sa më mirë zbatimin e legjislacionit, politikave dhe strategjive për të drejtat e njeriut. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike duhet të trajtojë shërbyesit civilë dhe zyrtarët e tjerë publikë në nivel qendror dhe vendor për të përmirësuar aftësitë për mbledhjen e të dhënave dhe monitorimit dhe të ndajë praktikat më të mira nga qendra në periferi.
- OShC-të vendore në veçanti, duhet të forcojnë kapacitetet e tyre në zbatimin e metodave të konsultimit publik, monitorimit dhe vlerësimit të politikave publike në mënyrë që të bëhen aktorë më të mirë civilë, t'i mbajnë institucionet publike në pozitë të llogaridhënies dhe të ndërlidhin më mirë komunitetet me institucionet. Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri duhet të asistojë organizatat vendore dhe grupet e terrenit duke ndarë praktikat më të mira në zbatimin e ligjeve dhe financave.
- Skuadra shumëdisiplinore që përfshijnë hulumtues, gazetarë investigues, shkencëtarë, ekspertë ligjorë dhe praktikues duhet të studiojnë në thellësi kapjen e shtetit dhe efektet e tij në hapësirën qytetare, demokratizimin, kulturën politike dhe mbarë hapësirën publike të Shqipërisë. Secili aktor është i domosdoshëm dhe i pazëvendësueshëm për këtë detyrë.



## REFERENCAT

- Agolli, Ilirian. (2017) 'Tiranë: Largohen nga puna gazetarë të njohur', Zëri i Amerikës 12 janar. <https://www.zeriamerikes.com/a/alfred-lela-armand-shkullaku-largime-nga-puna-media/3673675.html>
- Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, 'Raporte monitorimi'. <http://www.amshc.gov.al/web/raporte/monitorimi/>
- Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile. (2020) 'Treguesit e buxhetit të katër mujorit të II të vitit 2020 për institucionin AMSHC', Nr. Prot. 249, 22 shtator. [http://www.amshc.gov.al/web/raporte/monitorimi/2020/Raporti\\_per\\_4-mujorin\\_2\\_te\\_vitit\\_2020.pdf](http://www.amshc.gov.al/web/raporte/monitorimi/2020/Raporti_per_4-mujorin_2_te_vitit_2020.pdf)
- Autoriteti i Mediave Audiovize. (2020) 'Njoftim për mediat', 15 maj. <http://ama.gov.al/2020/05/15/njoftim-per-mediat/>
- Avokati i Popullit. (2019) Annual Report – on the activity of the Ombudsman's Institution, year 2018, maj. <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Annual%20Report%202018.pdf>
- Avokati i Popullit. (2020a) "Avokati i Popullit reagon mbi përplasjet në sheshin Skënderbej", 9 maj. <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/news/this-article-is-available-only-in-albanian-479/>
- Avokati i Popullit. (2020b) Annual Report – the activity of the People's Advocate Institution year 2019. <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Annual%20Report%202019.pdf>
- Avokati i Popullit. (2020c) Rekomandime mbi veprimet/ mosveprimet e kundërligjshme të strukturave të Policisë së Shtetit gjatë dhe pas prishjes së godinës së Teatrit Kombëtar, 17 nëntor. <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20Teatri%20Kombetar%20nentor%202020.pdf>
- Avokati i Popullit. (2020ç) 'Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme për respektimin e lirisë kushtetuese të tubimit edhe gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Re>

komandim%20p%C3%ABr%20marrjen%20e%20masave%20t%C3%AB%  
20nevojshme%20p%C3%ABr%20respektimin%20e%20liris%C3%AB%20  
kushtetuese%20t%C3%AB%20tubimit%20edhe%20gjat%C3%AB%20gje  
ndjes%20s%C3%AB%20jasht%C3%ABzakonshme.%20.pdf

Azizi, Orgest. (2020) 'Për një fenomenologji politike të protestës', Peizazhe të fjalës 5 dhjetor. <https://peizazhe.com/2020/12/05/per-nje-fenomenologji-politike-te-protestes/>

Balkan Civil Society Development Network. (2018) 'What can we do to promote civic space?' <http://www.balkancsd.net/novo/wp-content/uploads/2018/04/Pogledite-na-zapaden-balkan-i-turcija-ANG-01.pdf>

Balkanrivers. (2020) 'Energy Community tightens policy guidelines on small hydropower projects and opens procedures against Albania', 24 shtator. <https://www.balkanrivers.net/en/news/energy-community-tightens-policy-guidelines-small-hydropower-projects-and-opens-procedures>

BalkanWeb. (2020) 'VIP-at shqiptarë nuk pyesin për koronavirusin', 9 maj. <https://www.balkanweb.com/vip-at-shqiptare-nuk-pyesin-per-koronavirusin-me-bikini-ne-plazhet-e-jugut-e-duke-festuar-prane-zjarrit-gjate-darkave-ne-borsh/>

Baxhaku, Elton. (2018) Free flow, Dokumentar, Tiranë: BIRN. <https://www.youtube.com/watch?v=RPnQWY8KsE8>

Bino, Blerjana, Redon Qirjazi dhe Alban Dafa. (2020) Civil Society Participation in Decision-Making in Albania, Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2020/03/CSO-Participation-in-Decision-Making-in-Albania.pdf>

BIRN Albania. (2018) 'BIRN Albania's documentary 'Free flow' premiered', 11 qershor. <https://birn.eu.com/news-and-events/birn-albanias-documentary-free-flow-premiered/>

Carcani-Mane, Valbona. (2020) '[Albania] Parliamentary hearing session on the "Law on the Order of Social Work in Albania"', Child Protection Hub. <https://childhub.org/en/child-protection-news/albania-parliamentary-hearing-session-law-order-social-work-albania>

CIVICUS Monitor, 'Civic space'. <https://monitor.civicus.org/whatis-civicspace/>

- Komisioneri për të Drejtat e Njeriut. (2019) 'Commissioner urges Albania's Parliament to review bills which restrict freedom of expression', Strasburg: Këshilli i Evropës 17 dhjetor.  
<https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/commissioner-urges-albania-s-parliament-to-review-bills-which-restrict-freedom-of-expression>
- Csaky, Zselyke. (2020) 'Nations in Transit 2020 - Dropping the democratic facade', Washington DC: Freedom House.  
[https://freedomhouse.org/sites/default/files/2020-04/05062020\\_FH\\_NIT2020\\_vfinal.pdf](https://freedomhouse.org/sites/default/files/2020-04/05062020_FH_NIT2020_vfinal.pdf)
- Curri, Sami. (2020) 'Vendimi i Komisionerit: Albchrome i shkarkoi minatorët për shkak të angazhimit sindikal', Reporter.al 3 nëntor.  
<https://www.reporter.al/vendimi-i-komisionerit-albchrome-i-shkarkoi-minatoret-per-shkak-te-angazhimit-sindikal/>
- Daragahu, Borzohu. (2019) 'First they came for the morning show: How Albania's government shut down an entire TV station that dared to criticise it', Independent 15 shtator.  
<https://www.independent.co.uk/news/world/europe/albania-agon-tv-press-freedom-censorship-corruption-francesco-becchetti-a9103496.html>
- Di Liscia, Valentina. (2020) 'Open letter condemns the "Artwashing" of Albanian Prime Minister's politics', Hyperallergic 19 maj.  
<https://hyperallergic.com/565114/open-letter-condemns-artwashing-albania/>
- Dobrushji, Andi. (2016) 'How Albania is reforming its troubled justice system?' Open Society Foundation Albania 12 shkurt.  
<https://www.osfa.al/publikime/how-albania-is-reforming-its-troubled-justice-system>
- Dritare. (2020) "Shija e tmerrshme e përrurimit të TKOB", 21 maj.  
<https://dritare.net/ngjarjet-e-dites/shija-e-tmerrshme-e-perurimit-te-tob-191>
- Dyrmishi, Arjan në Max Brändle et al. (2020) Democracy and the state of emergency, Friedrich Erbert Stiftung 13 korrik.  
<http://library.fes.de/pdf-files/bueros/belgrad/16359.pdf>
- EcoAlbania. (2020) 'Lumi Cem – i kërcënuar nga ndërtimi i hidrocentraleve', 20 qershor. <https://www.ecoalbania.org/sq/2020/06/20/lumi-cem-i-kercenuar-nga-ndertimi-i-hidrocentraleve/>

- Environmental Justice Atlas. (2019) 'Poçem hydropower dam stopped', 18 gusht. <https://ejatlas.org/print/pocem-hydropower-dam-albania>
- Erebara, Gjergj. (2020) 'Albania 'Breached EU Directive' in Awarding Hydropower Plant Contract', BalkanInsight 15 shtator. <https://balkaninsight.com/2020/09/15/albania-breached-eu-directive-in-awarding-hydropower-plant-contract/>
- Europa Nostra. (2020) 'Europe's 7 Most Endangered heritage sites 2020 announced', 24 mars. <https://www.europanostra.org/europe-7-most-endangered-heritage-sites-2020-announced/>
- European Commission for Democracy through Law. (2020) 'Albania - Opinion on draft amendments to the Law no. 97/2013 on the Audio visual Media Service', Strasbourg, 19 qershor. [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2020\)013-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2020)013-e)
- Exit News. (2017) 'Artan Rama dhe Publicus fitojnë çmimin e dytë të Gazetarisë Investigative', 9 qershor. <https://exit.al/artan-rama-dhe-publicus-fitojne-cmimin-e-dyte-te-gazetarise-investigative/>
- Exit News. (2018a) 'Protesta kundër tarifave në Rrugën e Kombit – Çfarë dimë deri më tani?' 3 prill. <https://exit.al/protesta-kunder-tarifave-ne-rrugen-e-kombit-cfare-dime-deri-me-tani/>
- Exit News. (2018b) 'Journalist refuses to back down, Rama breaks off press conference', 18 maj. <https://exit.al/en/2018/05/18/journalist-refuses-to-back-down-rama-breaks-off-press-conference/>
- Exit News. (2018c) 'Government plunders state budget for Rruga e Kombit concession holder', 6 shtator. <https://exit.al/en/2018/09/06/government-plunders-state-budget-for-rruga-e-kombit-concession-holder/>
- Exit News. (2020a) 'AEJ Condemns Exclusion of Critical Journalist from Media Discussion with Prime Minister Edi Rama', 5 tetor. <https://exit.al/en/2020/10/05/135416/>
- Exit News. (2020b) 'Cukali: Politicians Pressured Media into Not Joining Self-Regulation Platform 'Ethical Media Alliance Self-Regulation'', 19 nëntor. <https://exit.al/en/2020/11/19/cukali-politicians-pressured-media-into-not-joining-self-regulation-platform-ethical-media-alliance-self-regulation/>

- Exit News. (2020c) 'Fier Waste Incinerator Concessionary Reported to Anti-Corruption Prosecution', 24 qershor.  
<https://exit.al/en/2020/06/24/fier-waste-incinerator-concessionary-reported-to-anti-corruption-prosecution/>
- Exit News. (2020d) 'Ballsh oil workers salary to come from COVID-19 fund', 19 nëntor. <https://exit.al/en/2020/11/19/ballsh-oil-workers-salary-to-come-from-covid-19-fund/>
- Gërguri, Dren. (2020) 'Çipa: Media pësoi goditje të rëndë nga pandemia, mbi 40 gazetarë humbën vendin e punës ndërkaq rreth 30% e gazetarëve pësuan ulje të pagave', Portalb 25 qershor.  
<https://portalb.mk/691471-cipa-media-pesoi-goditje-te-rende-nga-pandemia-mbi-40-gazetare-humben-vendin-e-punes-nderkaq-rreth-30-e-gazetareve-pesuan-ulje-te-pagave/>
- Grup me OShC. (2020) 'Kërkesë për seancë dëgjimore me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile për projektligjin "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse", 20 tetor. [http://resourcecentre.al/wp-content/uploads/2020/10/Per-projektligjin-Per-Regjistrimin-e-OJFve\\_Nga-organizatat-e-shoqerise-civile\\_Final.pdf](http://resourcecentre.al/wp-content/uploads/2020/10/Per-projektligjin-Per-Regjistrimin-e-OJFve_Nga-organizatat-e-shoqerise-civile_Final.pdf)
- Halo, Adela, Dorarta Hyseni, Dorian Matlija dhe Theodoros Alexandridis. (2015) A blind eye on news: self-censorship in the Albanian media, Tiranë: BIRN. <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2017/05/Report-on-self-censorship-in-the-Albanian-media.pdf>
- INFOCIP. (2020) 'Projektligji "Për referendimet" hyn në proces legjislativ. Nisma e INFOÇIP, e konsultuar me shoqërinë civile një hap më pranë realizimit përfundimtar', shtator. <https://www.infocip.org/al/?p=13560>
- Kajsiu, Blendi. (2011) 'Importi i mbetjeve si simptomë e kapjes', Panorama Online 2 nëntor. <http://www.panorama.com.al/importi-i-mbetjeve-si-simptome-e-kapjes/>
- Karaj, Vladimir. (2019) 'Last TV shows critical of Albanian government are cancelled', BalkanInsight 29 gusht.  
<https://balkaninsight.com/2019/08/29/last-tv-shows-critical-of-the-government-are-closed-down-in-albania/>
- Këshilli i Ministrave. (2020) 'Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19', Akti normativ nr. 3, datë 15.3.2020, Fletore Zyrtare (37) 15 mars.  
<https://qbz.gov.al/eli/akt-normativ/2020/03/15/3>

- Këshilli Shqiptar i Medias. (2020) 'AMC protests against the insulting and threatening messages towards the journalist Beti Njuma by the Mayor of Tirana', 18 gusht. <https://kshm.al/en/2020/08/18/amc-protests-against-the-insulting-and-threatening-messages-towards-the-journalist-beti-njuma-by-the-mayor-of-tirana/>
- Komiteti Shqiptar i Helsinkit. (2020) "Deklaratë e përbashkët për median", 11 prill. <https://ahc.org.al/deklarate-e-perbashket-per-median/>
- Matlija, Dorian dhe Irena Dule. (2019) 'Konsultimi publik në Shqipëri 2017-2018', ResPublika. <http://www.respublica.org.al/wp-content/uploads/2019/04/Konsultimi-Publik-2017-2018-Res-Publica-NED.pdf>
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2020a) 'Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura', Urdhri nr. 132, në 8.3.2020, Fletore Zyrtare (64) 10 prill. <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/03/08/132/9f294e1a-c737-4fc6-a46a-eea2a825c3eb>
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2020b) 'Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura', Urdhri nr. 633, në 17.11.2020, Fletore Zyrtare (210) 2 dhjetor. <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/11/17/633/5c8ca1e2-0838-4488-9f0b-2ecfbc756f45>
- Mirel, Pierre. (2019) 'European Union-Western Balkans: for a revised membership negotiation framework', Fondation Robert Schuman. <https://www.robert-schuman.eu/en/european-issues/0529-european-union-western-balkans-for-a-revised-membership-negotiation-framework>
- Nazifi, Ermal dhe Michael J. Orghia. (2020) Qeverisja e internetit në Shqipëri dhe roli i saj në lirinë e medias, Tiranë: BIRN Albania. <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2020/09/Qeverisja-e-internetit.pdf>
- Ndrevataj, Entela. (2020) 'Punimet për HEC-et kthejnë ujin e kaltër të Valbonës në një rrjedhë të zbardhur nga inertet', Citizens Channel, 25 shtator. <https://citizens-channel.com/2020/09/25/punimet-per-hec-et-kthejne-ujin-e-kalter-te-valbones-ne-nje-rrjedhe-te-zbardhur-nga-inertet/>

- Newsbomb. (2020) 'Organizatat e shoqërisë civile letër Ramës: Kërkojmë mbështetje financiare', 24 mars.  
<https://www.newsbomb.al/organizatat-e-shoqerise-civile-leter-rames-kerkojme-mbeshtetje-financiare-kane-ngelur-jashte-paketes-ekonomike-grupet-sociale-me-ne-nevoje-letra-e-plote-199860>
- Ora News. (2020) 'Skandal, ISSh kërkon mbylljen e sinjalit të RTV Ora', 15 maj <https://www.oranews.tv/article/skandal-ishsh-kerkon-mbylljen-e-sinjalit-te-rtv-ora>;
- OSBE. (2015) 'Albania should reject bill introducing imprisonment for libel of public officials, says OSCE Representative and calls for full decriminalization', Vienë: OSBE, 12 nëntor.  
<https://www.osce.org/fom/199446>
- Panorama Online. (2019) 'Dënimi për studentët që qëlluan Ramën me vezë. Apeli nuk u pranon ankimit. Ja arsyet', 18 mars.  
<http://www.panorama.com.al/denimi-per-studentet-qe-qelluan-ramen-me-veze-apeli-nuk-u-pranon-ankimimin-ja-arsyet/>
- Policia e Shtetit. (2020a) 'Raporti i ngjarjeve për 72 orët e fundit, Policia e Shtetit', 18 maj. <https://www.asp.gov.al/raporti-i-ngjarjeve-per-72-oret-e-fundit-policia-e-shtetit-34/>
- Policia e Shtetit. (2020b) 'Tiranë – Organizuan protestë të paligjshme, procedohen penalisht 9 persona', 19 maj.  
<https://www.asp.gov.al/tirane-organizuan-proteste-te-paligjshme-procedohen-penalisht-9-persona/>
- Politiko. (2018) 'S'ke faj që s'je përgatitur – Ilva Tare flet për ndodhinë me Edi Ramën', 2 qershor. <https://politiko.al/ske-faj-qe-sje-pergatitur-ilva-tare-flet-per-ndodhine-me-edi-ramen/>
- Porschlegel, Sophie. (2020) 'Countering shrinking spaces: Recommendations to support EU civil society', European Policy Centre, 11 qershor.  
[https://wms.flexious.be/editor/plugins/imagemanager/content/2140/PDF/2020/Countering\\_shrinking\\_spaces.pdf](https://wms.flexious.be/editor/plugins/imagemanager/content/2140/PDF/2020/Countering_shrinking_spaces.pdf)
- Presidenti i Republikës. (2020) 'Reasons for the return of law no. 91/2019 "For some amendments and additions to law no. 97/2013 "On the audio visual media in the Republic of Albania" as amended", 12 janar.  
<http://president.al/presidenti-meta-dekretion-kthimin-per-rishqyrtim-ne-kuvend-te-ligjit-nr-91-2019-arsyet-e-kthimit-per-rishqyrtim-te-ligjit/>

- Presidenti i Republikës. (2020) 'Reasons for the return of law no. 92/2029 "For some additions and changes to the law no. 9918 dated 19.5.2008, "On electronic communications in the Republic of Albania" as amended', 12 janar. <https://president.al/en/presidenti-meta-dekreton-kthimin-per-rishqyrtim-ne-kuvend-te-ligjit-nr-92-2019-arsyet-e-kthimit-per-rishqyrtim-te-ligjit/>
- Qëndresa Qytetare. (2020) '35 organizata dhe sindikata letër të hapur institucioneve për të drejtën e protestës në kohë pandemie', 19 nëntor. <https://qq.com.al/index.php/2020/11/19/35-organizata-dhe-sindikata-leter-te-hapur-institucioneve-per-te-drejten-e-protestes-ne-kohe-pandemie-mungesa-e-protestes-vret-demokracine-e-per-pasoje-jeten-e-qytetareve-te-cilet-nese-qeverisen-nuk/>
- Reporters Without Borders. World Press Freedom Index. <https://rsf.org/en/ranking>
- Schenkkan, Nate. (2018) 'Nations in Transit 2018 – Confronting illiberalism', Washington DC: Freedom House. [https://freedomhouse.org/sites/default/files/2020-02/FH\\_NationsInTransit\\_Web\\_PDF\\_FINAL\\_2018\\_03\\_16.pdf](https://freedomhouse.org/sites/default/files/2020-02/FH_NationsInTransit_Web_PDF_FINAL_2018_03_16.pdf)
- Shehu, Isuf et al (2020) The rule of law in emergency - An analysis of the Albanian case, Tirana: Akademia e Studimeve Politike, maj.
- Taylor, Alice Elizabeth. (2019a) 'International media freedom delegation: Albania not meeting human rights obligations', Exit News 21 qershor. <https://exit.al/en/2019/06/21/international-media-freedom-delegation-albania-not-meeting-human-rights-obligations/>
- Taylor, Alice Elizabeth. (2019b) 'Fifteen Arrests after Citizens Protest against Demolishment of Their Homes', Exit News 14 tetor. <https://exit.al/en/2019/10/14/fifteen-arrests-after-citizens-protest-against-demolishment-of-their-homes/>
- Tirana Echo. (2016) 'Musical protest to protect Albanian Alps and refuse waste import muted by Albanian media owners', 1 nëntor. <http://www.tiranaecho.com/albania/musical-protest-to-protect-albanian-alps-and-refuse-waste-import-muted-blocked-by-albanian-media-owners/>
- UNDP Albania. (2015) 'Support to Territorial and Administrative Reform - What is the programme about?' <https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/projec>



ts/democratic\_governance/support-to-territorial-and-administrative-reform.html

Vurmo, Gjergji et al (2010) Civil Society Index for Albania, In search of citizens and impact, Tirana: Institute for Democracy and Mediation. [http://www.civicus.org/images/stories/csi/csi\\_phase2/csi%20albania%20acr\\_eng.pdf](http://www.civicus.org/images/stories/csi/csi_phase2/csi%20albania%20acr_eng.pdf)

Vurmo, Gjergji dhe Orsiola Kurti. (2014) 'Bringing ASCS closer to the civil society', Institute for Democracy and Mediation, dhjetor. [https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2017/02/AMSHC-paper\\_ENG.pdf](https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2017/02/AMSHC-paper_ENG.pdf)

Vurmo, Gjergji. (2020) 'Tailor-made laws in the Western Balkans - State capture in disguise', Bruksel: CEPS 11 maj. <https://www.ceps.eu/ceps-publications/tailor-made-laws-in-the-western-balkans/>

WWF (2017). 'Legal struggle of local communities to protect Valbona Valley National Park from hydropower development', 12 korrik. <https://wwf.panda.org/?304271/Legal-struggle-of-local-communities-to-protect-Valbona-Valley-National-Park-from-hydropower-development>

Xhafa, Edlira. (2020) 'The difficult birth of an independent labour movement in Albania', 14 janar. <https://smbb.substack.com/p/the-difficult-birth-of-an-independent>

## **Raporte në vitet 2015-2020**

Indeksi i Qëndrueshmërisë së Organizatave të Shoqërisë Civile

United States Agency for International Development. (2015) The 2014 CSO Sustainability Index for Central and Eastern Europe and Eurasia. <https://idmalbania.org/csosi-usaid-report-for-albania/>

USAID. (2016) CSO Sustainability Index 2015 for Central and Eastern Europe and Eurasia, korrik, f. 12-20. <https://idmalbania.org/csosi-usaid-report-for-albania/>

USAID. (2017) CSO Sustainability Index 2016 for Central and Eastern Europe and Eurasia, korrik, f. 13-21. <https://idmalbania.org/csosi-usaid-report-for-albania/>

USAID, ICNL, fhi360. (2018) CSO Sustainability Index 2017 for Central and Eastern Europe and Eurasia, shtator, f. 12-19.

<https://idmalbania.org/csosi-usaid-report-for-albania/>

USAID, ICNL, fhi360. (2019) CSO Sustainability Index 2018 for Central and Eastern Europe and Eurasia, shtator, f. 11-19.

<https://idmalbania.org/csosi-usaid-report-for-albania/>

Azizaj, Evelina dhe Romario Shehu. (2020) 2019 Civil Society Organization Sustainability Index for Albania, USAID, ICNL, fhi360, IDM.

<https://idmalbania.org/csosi-usaid-report-for-albania/>

### **Komisioni Evropian**

European Commission. (2015) Albania 2015 Report, [Brussels, SWD (2015) 213 final], 10 nëntor. [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_albania.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2015/20151110_report_albania.pdf)

European Commission. (2016) Albania 2016 Report, [Brussels, SWD (2016) 364 final], 9 nëntor. [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2016/20161109\\_report\\_albania.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf)

European Commission. (2018) Albania 2018 Report, [Strasbourg, SWD (2018) 151 final], 17 prill. <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/default/files/20180417-albania-report.pdf>

European Commission. (2019) Albania 2019 Report, [Brussels, SWD (2019) 215 final], 29 maj. <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/default/files/20190529-albania-report.pdf>

European Commission. (2020) Albania 2020 Report, [Brussels, SWD (2020) 354 final], 6 tetor. [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf)

### **Freedom House**

Freedom House. (2020) 'Albania 2019'.

<https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2020>

Freedom House. (2019) 'Albania 2018'.

<https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2019>

Freedom House. (2018) 'Albania 2017'.

<https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2018>

Freedom House. (2017) 'Albania 2016'.

<https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2017>

### **Matrica e Monitorimit të Mjedisit Mundësues të Zhvillimit të Shoqërisë Civile**

Hoxha, Juliana et al. (2016) Monitoring Matrix on enabling environment for civil society development – Country report for Albania 2015, Tiranë: Partners' Albania for Change and Development.

[http://www.partnersalbania.org/Monitoring\\_Matrix\\_Albania\\_Country\\_Report\\_2015.pdf](http://www.partnersalbania.org/Monitoring_Matrix_Albania_Country_Report_2015.pdf)

Hoxha, Juliana et al. (2017) Monitoring Matrix on enabling environment for civil society development – Country report for Albania 2016, Tiranë: Partners' Albania for Change and Development.

[https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2017/07/Monitoring\\_Matrix\\_Albania\\_Country\\_Report\\_2016.pdf](https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2017/07/Monitoring_Matrix_Albania_Country_Report_2016.pdf)

Hoxha, Juliana et al. (2018) Monitoring Matrix on enabling environment for civil society development – Country report for Albania 2017, Tiranë: Partners' Albania for Change and Development.

<http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2018/07/Monitoring-Matrix-report-for-Albania-2017.pdf>

Hoxha, Juliana et al. (2019) Monitoring Matrix on enabling environment for civil society development – Country report for Albania May 2018-2019, Tiranë: Partners' Albania for Change and Development.

<http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2019/07/Monitoring-Matrix-Country-Report-for-Albania-2018.pdf?fbclid=IwAR2GGlwWpkXUetYr6NQdVI-Y3dv4L-BQTWS1SPCfri1qcXwtvVzAEcKbyTw>

Hoxha, Juliana et al. (2020) Monitoring Matrix on enabling environment for civil society development – Country report for Albania 2019, Tiranë: Partners' Albania for Change and Development.

<https://partnersalbania.org/publication/monitoring-matrix-on-enabling-environment-for-csos-development-country-report-for-albania-2019/>

## **Vendet në Tranzicion**

- Freedom House. (2015) 'Nations in Transit 2015 – Albania'.  
<https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2015>
- Lamallari, Besfort. (2016) 'Nations in Transit 2016 – Albania', Freedom House. <https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2016>
- Lamallari, Besfort. (2017) 'Nations in Transit 2017 – Albania', Freedom House. <https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2017>
- Kajsiu, Blendi. (2018) 'Nations in Transit 2018 – Albania', Freedom House. <https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2018>
- Freedom House. (2019) 'Nations in Transit 2019 – Albania'.  
<https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2019>
- Vurmo, Gjergji. (2020) 'Nations in Transit 2020 - Albania', Washington DC: Freedom House. <https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2020>

## **Sondazhi i opinionit publik “Besimi në Qeverisje”**

- Lame, Erisa dhe Aleka Pepa. (2016) Opinion poll 'Trust in governance' 2015, Tiranë: Institute for Democracy and Mediation, UNDP.  
<https://idmalbania.org/trust-in-governance/>
- Institute for Democracy and Mediation. (2017) Opinion poll 'Trust in governance' 2016, Tiranë: Institute for Democracy and Mediation, UNDP. <https://idmalbania.org/trust-in-governance/>
- Papa, Aleka dhe Marsela Dauti. (2018) Opinion Poll 'Trust in governance' 2017, Tiranë: Institute for Democracy and Mediation, UNDP.  
<https://idmalbania.org/trust-in-governance/>
- Papa, Aleka dhe Leonie Vrungtman. (2019) Opinion Poll 'Trust in governance' 2018, Tiranë: Institute for Democracy and Mediation, UNDP. <https://idmalbania.org/trust-in-governance/>
- Vrungtman, Leonie dhe Blerjana Bino. (2020) Opinion Poll 'Trust in governance' 2019, Tiranë: Institute for Democracy and Mediation, UNDP. <https://idmalbania.org/trust-in-governance/>

Vrungtman, Leonie dhe Marsela Dauti. (2021) Opinion Poll 'Trust in governance' 2020, Tiranë: Institute for Democracy and Mediation, UNDP. <https://idmalbania.org/trust-in-governance/>